



FLET PËR "EPOKËN E RE", ARIAN ZEKA ■ FAQE 8-9



KOSOVA JEP MESAZH NEGATIV PËR INVESTITORËT E HUAJ NËSE NDËRPRITET MARRËVESHJA PËR TC 'KOSOVA E RE'

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka kërkuar nga qeveria e re dhe Kuvendi që ta ndjekin një agjendë dinamike të zhvillimit ekonomik, e cila do ta mundësojë fuqizimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zeka ka folur edhe për taksën 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjës si dhe për termocentralin "Kosova e Re". Ai ka thënë se taksa 100 për qind është në kundërshtim me zotimet që Kosova ka dhënë edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë si dhe me ambiciet për integrim në BE, por

edhe për shkak se është kërkuar në vazhdimësi heqja e saj nga ShBA-ja. Ndërkaq ka pohuar se Oda Ekonomike Amerikane mbështet projektin e ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re", duke shpresuar se marrëveshja me "Contour Global" nuk do të ndërpritet për faktin se do të përçonte mesazh të keq për investorët e tjerë të huaj f. 8-9

SOT PËRBALLJA POZITË-OPOZITË PËR TAKSËN NË KUVEND

Pozita dhe opozita sot (e hënë) në Kuvend do të diskutojnë për paralajmërimin e kryeministrit Albin Kurti për heqjen e pjesshme të tarifës ndaj Serbisë. Përveç opozitës, propozimin e Kurtit e ka kundërshtuar edhe partnerja qeverisëse, LDK-ja. Lideri i kësaj partie, Isa Mustafa, i ka kërkuar Kuvendit të Kosovës që t'i propozojë qeverisë heqjen e tarifës ashtu siç ka kërkuar ShBA-ja. Ky sugjerim i ka pëlqyer të dërguarit special të presidentit Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i cili ka thënë se heqja e tarifës do të ishte një fillim i mbarë për Kosovën ■ FAQE 4-5



OPINION



GRENELL DHE KURTI F. 13

Ismet SYTLEJMANI

NE DHE AMERIKA F. 11

Mehmet PRISHTINA



AKTUALE



POLICIA ARRESTON 10 PERSONA, KONFISKON RRETH 60 KILOGRAMË DROGË F. 3

PËR MË PAK SE DY VJET, 13 RASTE TË VRASJEVE NË FAMILJE F. 6

EKONOMI

E DIELA DITË PUSHIMI? F. 8

KULTURË

TË BOTOHET VEPRA LETRARE DHE PUBLICISTIKE E ADEM DEMAÇIT NË 40 VËLLIME F. 14-15

Selatin NOVOSELLA



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepgishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqiptarët dhe maqedonasit krijojnë koalicionin e parë parazgjedhor

Lidhja Social Demokrate (LSDM), e cila aktualisht është në pushtet e që drejtohet nga ish-kryeministri Zoran Zaev, ka arritur marrëveshje me Lëvizjen Besa për pjesëmarrje me lista të përbashkëta në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 12 prill



SHKUP, 1 MARS - Lidhja e koalicionit të parë parazgjedhor mes një partie maqedonase dhe një partie shqiptare ka nxitur reagime të shumta në opinion mbi pasojat që mund të ketë në raportet ndëretnike, por edhe në ato mes partive politike. Lidhja Social Demokrate (LSDM), e cila aktualisht është në pushtet e që drejtohet nga ish-kryeministri Zoran Zaev, ka arritur marrëveshje me Lëvizjen Besa për pjesëmarrje me lista të përbashkëta në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 12 prill ka njoftuar rre.

Në deklaratën e miratuar dy partitë janë zotuar se do të angazhohen për "integrimin evropian të vendit si dhe për forcimin dhe kultivimin e vlerave mes bashkësive etnike në vend, duke i llogaritur si një pasuri e cila vetëm mund ta lehtësojë integrimin e shtetit drejt Bashkimit Evropian".

LSDM-ja dhe Lëvizja Besa thonë se do të angazhohen për zhvillim të barabartë në të gjitha sferat dhe gjithë territorin e shtetit pa dallim të përkatësisë etnike, luftimin e krimit dhe korrupsionit në të gjitha nivelet e pushtetit dhe reformim të gjyqësorit, si dhe për çështje tjera.

Lëvizja Besa në zgjedhjet e vitit 2016 kishte fituar pesë deputetë, por pas ndarjes së saj kishte mbetur me tre deputetë, pasi dy

të tjerë kanë kaluar në partinë e re Alternativa e cila ka hyrë në koalicion parazgjedhor me Aleancën për Shqiptarët që drejtohet nga Ziadin Sela.

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), që drejtohet nga Ali Ahmeti, e që është në koalicion me LSDM-në, koalicionin e partnerit të saj me Lëvizjen Besa e ka quajtur "të dëmshëm për shqiptarët" pasi sipas kësaj partie, shqiptarët koalicionet me partitë maqedonase duhet t'i bëjnë pas zgjedhjeve.

Duke komentuar reagimet në opinion, në veçanti ato të partive tjera ndaj një koalicioni të tillë, njohësit e çështjeve politike thonë se bëhet fjalë më tepër për demagogji sesa që ato në plan të parë kanë interesat kombëtare.

Muhamet Haliti, ish-deputet në disa përbërje parlamentare, thotë se është realitet se shqiptarët vetë të grumbulluar në një parti, pa një koalicion me partitë maqedonase, nuk do të mund ta bëjnë qeverinë sikur edhe maqedonasit që nuk do të mund të formojnë qeveri pa partitë shqiptare sepse, thotë ai, Maqedonia e Veriut është shoqëri dhe shtet shumetnik bazuar në Kushtetutë.

Halili nuk sheh asgjë të keqe nga një koalicion i tillë nëse, siç thotë, është i ndërtuar mbi parime të qarta programore. "Nëse një koalicion i tillë është bërë në

bazë të parimeve programore mendoj se nuk ka ndonjë ndryshim nëse do të bëhet para apo pas zgjedhjeve. Konsideroj se koalicionet parazgjedhore janë më stabile pasi bazohen në parime të qarta programore. Nuk mendoj se ka diçka negative pse kemi një koalicion mes një partie maqedonase dhe një shqiptare, pasi koalicionet të tilla kemi edhe pas çdo procesi zgjedhor. Arsyetimet kundër koalicionëve parazgjedhore janë demagogjike se gjoja me koalicionet paszgjedhore i kushtëzojnë partitë maqedonase e kështu me radhë", thotë Halili.

Ai konsideron se koalicionet e tilla mund të zgjerohen edhe me partinë tjetër maqedonase,

VMRO-DPMNE-në, nëse subjektet harmonizojnë programet e tyre dhe që më parë e njoftojnë elektoratin se cilat janë synimet e tyre dhe jo nëpër fushata të dalin me premtimet të mëdha, të cilat i heshtin futjes në qeveri. "Unë konsideroj se duhet të bëhen koalicionet të tilla parazgjedhore edhe me VMRO-DPMNE-në, nëse përputhen përcaktimet programore. Në këtë rast situata do të jetë e qartë se çfarë do të marrin përsipër partitë e koalicionit parazgjedhor të realizojnë brenda një cikli zgjedhor", thotë ish-deputeti Muhamet Halili. Por, disa njohës të tjerë të çështjeve politike thonë se koalicioni parazgjedhor mund

të sjellë pakënaqësinë në radhët e dy komuniteteve, i nxitur edhe nga partitë tjera të cilët për të mbrojtur pozicionet e tyre hedhin akuza nga më të ndryshme ndaj një koalicioni të këtillë. "Mund të ketë, për shembull, rezistencë në disa prej zonave elektorale të vendit për një koalicion të tillë, por edhe në një pjesë të elektoratit shqiptar, i cili nuk preferon ose refuzon të shkojë në një koalicion me një bllok tjetër etnik. Për momentin është vështirë të parashikohen zhvillimet pasi është hera e parë që ndodh diçka e tillë, pasojat janë të mundshme", thotë Gjorgji Spasov, ish-deputet dhe njohës i çështjeve politike.

Presidenti Meta fton qytetarët të manifestojnë kundër puçit kushtetues



TIRANË, 1 MARS - Sot (e hënë) në orën 17:00 presidenti Ilir Meta ka thirrur qytetarët të manifestojnë kundër asaj që ai e quan puç kushtetues. Manifestimi pritet të zgjasë rreth dy orë, ndërsa mësohet se qytetarët në fillim do të grumbullohen në bulevard para institucionit të presidencës e më pas do të marshohet drejt kryeministrit.

Përveç takimeve dhe bisedave me qytetarët, kreu i shtetit pritet që të ketë edhe një fjalim ku do t'iu drejtohet shqiptarëve. Gjithashtu, mes manifestuesve, Meta ka njoftuar se do të firmosë

dhe atë që e quan dekreti i parë kundër puçit.

Presidenca nuk ka njoftuar se çfarë përmban ky dekret, por pritet që të jetë pikërisht refuzimi i Ligjit për betimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Presidenca ka njoftuar dhe ka kërkuar nga policia e shtetit të marrë masa për mbarëvajtjen e manifestimit, kurse burime pranë policisë bënë me dije se nuk do të ketë masa shtesë edhe për faktin se nuk ka informacione për trazira apo incidente.

Kreu i shtetit ka ftuar në manifestim gjithë shqiptarët,

ndërsa do të mbajnë në duar lule mimoze dhe flamuj kombëtarë. Të dielën kreu i shtetit ka publikuar në rrjetet sociale mesazhe të qytetarëve të thjeshtë, por dhe sportistë apo artistë që do t'i bashkohen manifestimit.

Ndërsa për ish-ministrin e Brendshëm Teknik, Dritan Demiraj, Rama po tenton që ta marrë presidencën. Demiraj është shprehur se tubimi i Metës duhet të jetë sa më paqësor dhe demokratik. Ai tha se do të jetë personalisht në bulevard ashtu si të gjithë shqiptarët.

Gjermania me rregulla të reja për ata që dëshirojnë të punojnë në këtë shtet

Më 1 mars kanë hyrë në fuqi rregullat e reja rreth imigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar në Gjermani. Ligji i ri krijon mundësi të reja për punonjësit me kualifikim të njohur në arsim profesional nga shtetet joanëtare të BE-së për të punuar në Gjermani. Ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, ka thënë se Gjermania ka nevojë për fuqi punëtore të kualifikuar

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 MARS - Të dielën ka hyrë në fuqi Ligji për fuqinë punëtore të kualifikuar në Gjermani, i cili rregullon shkuarjen e punëtorëve në këtë shtet nga vendet jashtë Bashkimit Evropian.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, nëpërmjet një videoje në rrjetin social "Facebook" ka dhënë hollësi në lidhje me këtë ligj. "Më 1 mars 2020 do të hyjë në fuqi Ligji i migracionit në Gjermani. Me këtë rast nuk bëhet fjalë për kuota të reja për leje pune për punonjës nga Ballkani Perëndimor, por për një rregull që vlen në mbarë botën", ka thënë Heldt.

Ai ka pohuar se Gjermania ka nevojë për fuqi punëtore të kualifikuar. "Kjo është një rregull për fuqi punëtore të kualifikuar, e cila mund ta organizojë migrimin në Gjermani në bazë të këtij rregulli të ri ligjor. Por fuqi e kualifikuar punëtore do të thotë të kesh kualifikim profesional në cilindo sektor, i cili duhet të njihet në Gjermani përpara se të mund të parashtrahet një kërkesë për vizë.

Në gjithë këtë, prioritet për ne është që kjo ndërlidhet edhe me idenë e migrimit qarkullues, që do të thotë se kualifikimet e reja, të cilat merren në Gjermani, mund të barten më vonë në jetën profesionale në Kosovë për ta zhvilluar edhe më tej ekonominë e këtushme. Edhe në këtë pikë Gjermania këtu në Kosovë ka një gamë të gjerë instrumentesh për të ndihmuar në jetën profesionale në vend", është shprehur ambasadori Heldt.

ÇFARË ËSHTË LIGJI RRETH IMIGRIMIT TË FUQISË PUNËTORE TË KUALIFIKUAR DHE ÇFARË KA NDRYSHUAR?

Ligji rreth imigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar u mundëson punonjësve të kualifikuar në arsim profesional nga shtetet jashtë Bashkimit Evropian (Shtete të Treta) të emigrojnë më lehtë në të ardhmen në drejtim të Gjermanisë. Përcaktimet ligjore ekzistuese për punonjës të kualifikuar me diplomë të shkollës së lartë/universitare vazhdojnë të



mbeten të vlefshme. Gjithsesi për hyrjen në Gjermani me qëllim nisjen e një marrëdhënieje punësimi apo kërkimin e një vendi pune do të vazhdojë të jetë e nevojshme pajisja me vizë, për të cilën duhet të aplikoni pranë Ambasadës Gjermane.

Kush konsiderohet si fuqi punëtore e kualifikuar sipas ligjit të ri? Si fuqi punëtore e kualifikuar konsiderohen të diplomuarit në universitete si dhe personat me një kualifikim në arsimin profesional që njihet në Gjermani. Një diplomë profesionale konsiderohet zakonisht si e kualifikuar dhe njihet, nëse në Gjermani ajo do të merrej pas një periudhe së paku dyvjeçare të arsimit profesional.

Çfarë nevojitet për ta parashtruar kërkesën për një vizë për nisje të punësimit si punonjës i kualifikuar në Gjermani?

Së pari duhet të njihet kualifikimi e më pastaj të parashtrahet kërkesa për vizë. E rëndësishme është që ju fillimisht ta bëni njohjen zyrtare të kualifikimit tuaj të huaj nga autoritetet përgjegjëse në Gjermani. Informacionet e mëtejshme rreth procedurës së njohjes së diplomës i gjeni në këtë link: www.anerkennung-in-deutschland.de. Punëkërkuessit e kualifikuar duhet të fillojnë këtë procedurë me kohë. Këtë mund ta bëjnë edhe para hyrjes në fuqi të rregullave të reja, në mars të vitit 2020.

Sapo të merrni vendimin për

njohjen e kualifikimit dhe të keni një ofertë konkrete për një vend pune në Gjermani, mund të aplikoni për vizë për të punuar në Gjermani në atë profesion për të cilën jeni kualifikuar. Duhet të jetë angazhim i kualifikuar, ndërsa veprimtaritë ndihmëse, apo me qëllim të mësimi të profesionit janë shprehimisht të përjashtuara. Nëse keni një diplomë të kualifikimit profesional së paku dyvjeçare, apo diplomë universitare të lëshuar nga një shkollë/universitet gjerman, atëherë nuk është e nevojshme nisja e procedurës për njohjen e diplomës.

Parashtrimi i kërkesës për vizë është i mundur pas datës 1 mars 2020.

Policia arreston 10 persona, konfiskon afro 60 kilogramë drogë

Policia e Kosovës brenda 24 orëve të fundit ka konfiskuar rreth 60 kilogramë substancë të dyshuar narkotike dhe ka arrestuar dhjetë persona të dyshuar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 MARS - Policia e Kosovës (PK), konkretisht hetuesit e Drejtorisë Kundër Trafikimit të Narkotikëve, më 29 shkurt, në tri operacione policore, ka arrestuar dhjetë persona të dyshuar dhe ka konfiskuar rreth 60 kilogramë substanca të dyshuara narkotike.

Operacioni kryesor policor është zhvilluar të shtunën në mbrëmje rreth orës 21:00 në rrugën Gjakovë-Klinë, ku pas një procesi hetimor dhe aplikimit të masave, siç parashihen me ligjet në fuqi, janë ndaluar dy automjete në të cilat dyshohej se po transportoheshin substancë e dyshuar narkotike.

Hetuesit e antidrogës së Policisë së Kosovës në njërin nga automjetet e dyshuara kanë gjetur dhe konfiskuar disa qese të mbështjella me substancë të dyshuar narkotike me peshë totale prej 57.5 kilogramësh.

Në këtë rast janë arrestuar katër persona të dyshuar dhe, përveç substancave të dyshuara narkotike, janë konfiskuar edhe dëshmi tjera të relevante si: para, një revole, automjete dhe telefona mobilë.

Po të shtunën në mbrëmje në dy raste të tjera në Gjakovë dhe në Fushë-Kosovë janë arrestuar edhe gjashtë persona të tjerë: pesë shqiptarë dhe një serb, nën dyshimin për "blerje, posedim, shitje dhe shpërndarje të substancave psikotrope analoge"



dhe "falsifikim të parasë" dhe, po ashtu, janë konfiskuar sasi e substancave narkotike dhe dëshmi të tjera që mund të përdoren në procedurë penale. Policia e

Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar për parandalimin dhe luftimin e dukurive negative në vend, në veçanti luftë e pakompromis do të zhvillohet

ndaj të gjithë atyre që merren apo abuzojnë me substanca narkotike dhe në një mënyrë apo tjetër rrezikojnë sigurinë apo jetën e të rinjve tanë.



Sot (e hënë) Kuvendi i Kosovës mban seancë për taksën ndaj produkteve serbe

SOT PËRBALLJA POZITË-OPOZITË PËR TAKSËN NË KUVEND

Pozita dhe opozita sot (e hënë) në Kuvend do të diskutojnë për paralajmërimin e kryeministrit Albin Kurti për heqjen e pjesshme të tarifës ndaj Serbisë. Përveç opozitës, propozimin e Kurtit e ka kundërshtuar edhe partnerja qeverisëse, LDK-ja. Lideri i kësaj partie, Isa Mustafa, i ka kërkuar Kuvendit të Kosovës që t'i propozojë qeverisë heqjen e tarifës ashtu siç ka kërkuar ShBA-ja. Kjo i ka pëlqyer të dërguarit special të presidentit Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i cili ka thënë se heqja e tarifës do të ishte një fillim i mbarë për Kosovën

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 MARS - Kuvendi i Kosovës sot (e hënë) do të diskutojë për taksën ndaj produkteve serbe, ndërsa pozita dhe opozita kanë qëndrime të ndryshme për këtë çështje. Madje qëndrim të bashkuar për tarifën 100 për qind ndaj mallrave serbe nuk kanë as partnerët e koalicionit qeverisëse. Një ditë para mbajtjes së seancës të thirrur nga opozita, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, i ka kërkuar Kuvendit që t'i rekomandojë qeverisë heqjen e tak-

sës ashtu siç kanë kërkuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtë rekomandim të Mustafës e ka mbështetur i dërguari i presidentit Trump për dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori Richard Grenell. Në llogarinë e tij në "Twitter", ai ka shkruar se heqja e tarifës të hënën do të ishte një fillim i mbarë. "Postim shumë i mirë. Isa Mustafa është lider i guximshëm. Heqja e tarifës nesër do të ishte fillim i shkëlqyeshëm për më shumë përparim dhe do të kishte lëvizje të shpejtë. Por, zhvillimi ekonomik nuk mund të ecë

përpara derisa të mos hiqet tarifa", ka shkruar Grenelli. Lideri i LDK-së përmes një postimi të gjatë në profilin e vet në "Facebook" ka treguar arsyet se pse taksa duhet të hiqet. Ai ka vlerësuar se që nga fillimi është shprehur haptas se tarifa 100 për qind, e caktuar nga qeveria Haradinaj, nuk kishte arsytet ekonomik, por ishte vënë për t'u mbrojtur nga dështimet në politikën e jashtme. Sipas tij, presidenti serb i ka dhënë tarifës dimension të kushtëzimit të dialogut. "Pas zgjedhjeve të vitit të kaluar të Komisionit Evropian, sidomos pas

angazhimit shumë aktiv të ShBA-së me përfaqësuesin special të presidentit Trump, ambasadorin Grenell, tarifa objektivisht mbetet vetëm si relik, i cili po i shërben Serbisë të paraqitet si viktimë në arenën ndërkombëtare dhe disave në Kosovë si mjet i vetëm i një kauze të paqëndrueshme politike", ka shkruar Mustafa, duke shtuar se Kuvendi në mbledhjen e të hënës duhet t'i japë përkrahje Qeverisë për ta hequr tarifën. "Askujt nuk i mbushet mendja se Kosova e detyron Serbinë që ta njohë përmes tarifës. Por, shumicës dërrmuese i mbushet mendja se ShBA-ja në rend të parë dhe BE-ja mund ta bindin Serbinë, përmes procesit të dialogut, që ta njohë shtetin e Kosovës. Dëshiroj të besoj se mbledhja e nesërme e Kuvendit do t'i japë përkrahje qeverisë dhe kryeministrit Kurti të hiqet tarifa. Të hiqet ashtu siç po kërkon ShBA-ja", ka vlerësuar Mustafa. Sipas tij, Kosova nuk

ka partner më të fortë e më të përkushtuar sesa ShBA-në. "Nëse dikush luhartet, LDK-ja, deputetët e saj dhe anëtarët e qeverisë do të mbështesin pa asnjë rezervë dhe me besim e bindje të plotë heqjen e menjëhershme të tarifës, jo vetëm se po e kërkon partnerja jonë strategjike - ShBA-ja, por se jemi të bindur se kjo është në interes të shtetit të Kosovës. Në qoftë se Serbia nuk e ndal fushatën kundër Kosovës dhe nuk mënjanon pengesat tregtare dhe ekonomike, LDK-ja mbetet e përkushtuar për aplikimin e masave të reciprocitetit pas një periudhe që qeveria e akordon me ShBA-në dhe BE-në", ka shkruar Mustafa. Kurse kryetarja e Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetarja e LDK-së, Vjosa Osmani, ka thënë se nga dita e hënë do të diskutohet më hollësisht për çështjen e taksës 100 për qind të vendosur ndaj produkteve që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë e



Hercegovina. “Për taksën jemi takuar të premtën, kurse nga e hëna mund të flasim më në detaje për këtë çështje”, ka thënë Osmani. Propozimin e Kurtit për heqje të pjesshme të taksës e ka kundërshtuar edhe presidenti Hashim Thaçi, duke thënë se me këto veprime qeveria e re po e thellon izolimin e Kosovës dhe po i prish raportet me ShBA-në. “Kokëfortësia, mungesa e veprimeve dhe e vendimeve të mençura e ka thelluar izolimin e Kosovës dhe ka prishur në mënyrë të ndjeshme raportet tona speciale me ShBA-në. Mbetja në fuqi e tarifës është pengesë serioze dhe e pamundëson bashkëpunimin strategjik dhe investimet e reja të fuqishme amerikane në Kosovë. Prandaj, nevoja që me urgjencë të merren vendimet e duhura ishte kërkesë dhe mesazh kryesor në takim me sekretarin Pompeo dhe me këshilltarin për Siguri Nacionale, O’Brien”, ka vlerësuar Thaçi.

Rama e Haradinaj sërish polemizojnë për taksën

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ka dhënë mbështetje kryeministrit Albin Kurti, i cili ka propozuar heqjen e pjesshme të tarifës ndaj mallrave serbe. Përmes një postimi në llogarinë e vet në “Twitter”,

ai ka kërkuar nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj që t’i ndalë kritikën ndaj kryeministrit aktual.

“Me paturpësi Ramushi ka nisur baltosjen e Albin Kurtit! Albin mund të jetë gjithçka, por kurrë nuk është shërbëtor i Serbisë. Uroj të mos tutet prej sulmeve të ulëta për heqjen e taksës që shkatërroi reputacionin ndërkombëtar të Kosovës dhe viktimizoi Serbinë në sytë e botës! Kurrë nuk është dëgjuar një idiotësi më e madhe sesa predikimi që taksa do ta sjellë njohjen e Kosovës nga Serbia dhe asgjë s’i ka bërë më shumë dëm Kosovës sesa ajo taksë e kthyer nga një thirrje për vëmendje ndaj shkeljeve të CEFTA-s nga Serbia, në një litar në fytin e Kosovës!”, ka shkruar Rama, duke shtuar se Kurti është në rrugën e duhur. “Albin Kurti është në rrugën e duhur! Heqja e taksës do të jetë dita e parë e tij si kryeministër në zyrë, jo më si lider opozite në zyrën e kryeministrit! Do t’i duhet të përballet me etiketën e ‘tradhtarit’ po ani, ajo etiketë i dalton udhëheqësit e paqes nga statujat e luftës”, ka shkruar Rama.

Këtyre kritikave iu ka përgjigjur lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, duke thënë se është i kuptueshëm frustrimi i Edi Ramës ndaj tij. “I kuptueshëm frustrimi i Edi Ramës ndaj meje. E di që nuk ma fal dot që ia prisha planin serbomadhi. Edi Rama, pas kthimit nga Moska, vepron pa humbur kohë për zbatimin e këshillave të Lavrovit. Uroj që kryeministri Kurti ta vazhdojë rrugën time të bllokimit të shtegut të Edi Ramës e të tjerëve për copëtimin e Kosovës dhe fuqizimin e Serbisë e Rusisë në rajonin tonë, duke mbajtur taksën deri në kontratën finale për njohje. Të tjerat janë tashmë histori”, ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në “Facebook”. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paraqitur javën e kaluar planin për heqjen e taksës. Ai ka njoftuar se më 15 mars do të hiqet taksa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Ai ka thënë se nëse Serbia ndal fushatën për çnjohje dhe zotohet për heqjen e barrierave jotarifore, nga 1 prilli taksa do të hiqet për një periudhë prej 90 ditësh. Nëse Serbia nuk u përmbahet këtyre zotimeve, sipas Kurtit, nga 15 qershori do të rivendoset taksa 100 për qind dhe do të zbatohet parimi i reciprocitetit.

Propozimi i kryeministrit Kurti është kundërshtuar nga ShBA-ja, duke kritikuar Kurtin se po bën gabim serioz me mosheqjen e taksës plotësisht.

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur me kërkesë të 41 deputetëve opozitarë, do të fillojë në orën 11:00.

E DIELA DITË PUSHIMI?

PRISHTINË, 1 MARS - Debati i ngritur kohën e fundit, se a duhet të jetë e diela ditë pushimi në nivel vendi, po mirëpritet nga shumë punëtorë dhe qytetarë, ndërkaq po kundërshtohet nga afaristët dhe përfaqësuesit e bizneseve. Në disa komuna të Kosovës tashmë nuk punohet në ditën e diel.

Përfaqësues të punëtorëve konsiderojnë se respektimi i të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, konkretisht orari dhe ditët e punës, janë të obligueshme për punëdhënësin, sipas Ligjit të punës.

Kurse përfaqësuesit e bizneseve konsiderojnë se me ndalimin e punës së bizneseve gjatë të dielave do t’i kufizonte aktivitetet ekonomike të tyre dhe rrjedhimisht edhe zvogëlimin e numrit të punëtorëve.

Në Kosovë në ditët e fundjavës kryesisht punojnë subjektet shërbyese, tregtare, si kafenetë, qendrat tregtare dhe dyqanet. Por, problemi, sipas afaristëve, qëndron edhe te fakti që të dielave këto biznese kanë qarkullim më të madh financiar, që nënkupton edhe fitime më të mëdha.

Pëllumb Bajqinovci, pronar i një lokali në qendër të Prishtinës, thotë se një ditë më pak pune nënkupton zvogëlim të të hyrave financiare. “Prishtina gjatë vikendeve po ‘vdes’. Shumica e familjarëve dhe atyre që kanë kushte financiare po lëvizin jashtë kryeqytetit. Prandaj, një ditë më pak gjatë javës ose katër ditë gjatë një muaji, do ta dëmtonte seriozisht pjesën financiare të biznesit”, ka pohuar Bajqinovci për “Radion Evropa e Lirë”.

Por, ndryshe nga afaristët një vendim të tillë e mirëpresin punëtorët dhe disa qytetarë. Albani punon në një dyqan të vogël në kryeqytet. Edhe pse

heziton të flasë, ai shkurt përgjigjet se do të ishte mirë që të pushohet ditën e diel. “Përtoj të punoj në ditë pushimi sepse duhet të jetë pushim për të gjithë. Mendoj se është vendim i qëlluar për të gjithë që e diela të jetë ditë pushimi”, ka thënë ai.

Rrezarta Ahmeti, studente në Universitetin e Prishtinës, e konsideron vendim të domosdoshëm ndalimin e punës ditën e diel. Ajo thotë se vikendi duhet të shfrytëzohet me familje. “Unë mendoj se është opsion i mirë që të pushohet të dielën për shkak se edhe fëmijët kanë nevojë që t’i kenë të dy prindërit në shtëpi gjatë vikendit ose, nëse punojnë, le t’i paguajnë punëtorët më shumë sesa ditët e punës”, thotë ajo.

Përfaqësues të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) thonë se disa nga kuvendet komunale që tashmë kanë marrë vendim që të mos punohet të dielën kanë shkelur Ligjin e punës.

Jusuf Azemi nga BSPK thotë se organet kompetente duhet ta kontrollojnë tregun se a respektohet orari i punës prej 40 orësh në javë dhe jo të ndalet puna ditën e diel. “Ne jemi të gatshëm të punojmë edhe të shtunën edhe të dielën, por konform Ligjit të punës. Kryetarët e komunave nuk e kanë pasur qëllimin të pushimi i punëtorëve. Qëllimi është që gjoja po arrijmë diçka për përmirësim të kushteve të punëtorëve, por me këto vendime kanë shkelur Ligjin e punës”, ka deklaruar Azemi.

Në Ligjin e punës thuhet se ndarjen e orarit të punës në kuadër të javës së punës e përcakton punëdhënësi. Java e punës mund të organizohet ndryshe, në rast se punëdhënësi e organizon punën me

ndërrime, gjatë natës ose kur natyra e punës e kërkon një gjë të tillë. Por, orari i plotë i punës duhet të jetë 40 orë në javë. “Nëse të punësuarit i duhet të punojnë në ditën e pushimit javor, atij duhet t’i sigurohet një ditë pushimi gjatë javës së ardhshme”, thuhet në ligj.

Edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit e kanë kundërshtuar vendimin e disa kuvendeve komunale që ta ndalojnë punën në ditën e diel. Oda Ekonomike Amerikane në Prishtinë përmes një komunikate shpreh shqetësimin e saj lidhur me vendimet e këtyre komunave.

Ky vendim, sipas Odës Ekonomike Amerikane, do t’i kufizojë aktivitetet ekonomike dhe rrjedhimisht do të ketë implikime në thellimin e mëtejshmë të nivelit të papunësisë në vend. Kurse Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës thotë se mbyllja e bizneseve të dielën nuk sjell dobi për asnjë subjekt në Kosovë, por është më se e qartë se do të sjellë shumë dobi te vendet e rajonit. “Paratë që shpenzohen në vendin tonë do të shpenzohen në Shkup, Tiranë e vende të tjera”, ka theksuar Rukiqi.

Numri më i madh i të punësuarave gjenden në sektorin privat. Nga 350 mijë të punësuar në nivel vendi, sipas të dhënave zyrtare, në sektorin privat janë të punësuar rreth 250 mijë, ndërkaq në sektorin publik 85 000. Derisa në sektorin publik zbatohet orari pesë ditë punë dhe dy në fundjavë me gjithsejtë 40 orë punë, në sektorin privat, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, është raportuar se të punësuarit në kompani private punojnë me orar më të gjatë, krahasuar me të gjitha llojet e punësimit deri në rreth 47 orë në javë.



Për më pak se dy vjet, 13 raste të vrasjeve në familje

PRISHTINË, 1 MARS - Vetëm gjatë dy muajve të parë të këtij viti në Kosovë u shënuan shtatë raste të vrasjes në familje. Në njërin rast, djali vrau prindërit, ndërkaq rasti i fundit ka qenë më 18 shkurt të këtij viti, kur një zyrtare policore vrau prindërit, dy vëllezërit dhe më pas bëri vetëvrasje.

Ndërkaq gjatë vitit të kaluar kanë ndodhur gjashtë raste të vrasjeve brenda familjes. Në katër raste ishin shënuar krime të vrasjes së grave nga burrat e tyre, ndërkaq në një rast vëllai kishte vrarë vëllanë dhe në një rast tjetër, nëna fëmijën e vet. Këto janë të dhënat e Policisë së Kosovës, sipas të cilave, në vitin 2019 janë iniciuar për hetim 1951 raste të dhunës në familje. Ndërkaq sa i përket gjinisë, sipas Policisë së Kosovës, 1 557 viktimat të këtyre rasteve kanë qene femra dhe 788 meshkuj. Policia ka arrestuar 788 persona të dyshuar për përfshirje në rastet e cilësuar si dhunë në familje.

Daut Hoxha, zëdhënës në Policinë e Kosovës, flet edhe për të dhënat për vitet paraprake sa i përket dhunës në familje. “Në vitin 2018 policia ka iniciuar 1 541 raste të ‘dhunës në familje’. Sa i përket gjinisë, 1 189 viktimat

të këtyre rasteve kanë qene femra dhe 308 meshkuj. Viktimat sa i përket moshës, grupmoshat më të shpeshta janë ato 20-30 vjeçare dhe 30-40 vjeçare. Policia ka arrestuar 499 persona të dyshuar për përfshirje në rastet ‘dhunë në familje’”, tha Hoxha për “Radion Evropa e Lir’.

Derisa në vitin 2017 ai ka pohuar se policia ka iniciuar 1 269 raste të ‘dhunës në familje’. ‘Sa i përket gjinisë, 958 viktimat të këtyre rasteve kanë qene femra dhe 261 meshkuj. Viktimat sa i përket moshës, grup-moshat më të shpeshta janë ato 20-30 vjeçare dhe 30-40-vjeçare. Policia ka arrestuar 400 persona të dyshuar për përfshirje në rastet ‘dhunë në familje’”, ka thënë Hoxha.

Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se e gjithë shoqëria duhet të angazhohet në mënyrë që të ndikohet në ndaljen dhe uljen e rasteve të vrasjeve, sidomos në familje. Ajo thotë se institucionet gjegjëse duhet të angazhohen më shumë që të dihet se kush ka armë dhe si qëndrojnë me shëndetin mendor, pasi edhe kjo paraqet rrezik për shoqërinë. “Deri tash shteti ka reaguar, pasi vrasësit po



zbulohen, por më pas, sa po dënohen shtrohet pyetja. Kemi pasur dy raste kur vrasësit janë dënuar me burgim të përjetshëm, por më pas lënda është kthyer në rigjykim. Do të shohim nëse do të ulet dënimi. Kjo jep shenja që nuk po i marrin dënimet meritore, në këtë rast vrasësit e grave. Gjithë shoqëria duhet të angazhohet dhe të vetëdijesohet që të ndryshojë situata”, është shprehur Berisha.

Në Kosovë, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, numri i armëve ilegale në posedim të qytetarëve llogaritet

të jetë rreth 260 mijë sosh. Ndërkaq numri i përgjithshëm i armëve legale në posedim të qytetarëve është afër 50 mijë. Berisha shton se armët ilegale në duart e qytetarëve përbëjnë rrezik për shoqërinë dhe kërkon kontroll të shtuar nga autoritetet e rendit.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës dënimin më të rëndë për vrasje parasheh dënimin me burgim të përjetshëm.

Zëdhënësi i Gjykatës së Apelit, Arbër Jashari, në një përgjigje për “Radion Evropa e Lirë” kohë më parë pati thënë se kjo gjykatë ka vërtetuar dy dënime me burgim të përjetshëm, mirëpo ato janë kthyer

në rigjykim.

Ndërkaq në Institutin e Kosovës për Drejtësi, institut ky që monitoron rastet në gjykata, thonë se deri më tani është shpallur vetëm një dënim me burgim të përjetshëm, kurse për gjashtë raste të tjera gjykatat në shkallën e parë kanë shpallur dënim të përjetshëm, të njëjtat janë ndryshuar apo kthyer në burgim me vite nga 22 deri 37, kurse disa të tjera janë kthyer në rigjykim.

Në këtë Institut thonë se masat e ashpra ndëshkimore nuk po arrijnë qëllimin në mënyrë që rastet e vrasjeve në familje të parandalohen.

Kurti thotë se qeveria do të investojë në rritjen e kapaciteteve të FSK-së



PRIZREN, 1 MARS (ER) - Në hotelin “Sharr” në Prevallë të Prizrenit, në fundjavë, qeveria e drejtuar nga Albin Kurti ka prezantuar draftin e programit qeverisës për të cilin ka diskutuar secili ministër. Kryeministri Kurti ka thënë se kanë filluar çkapjen e shtetit nga shpërdorimi duke përmirësuar bordet e ndërmarrjeve publike në të cilat ka pasur keqpërdorime të parasë publike, por edhe të keqmenaxhimit duke shkaktuar

humbje. “Kemi reduktuar pushtetin dhe kemi ndalur shpenzimet që të kuptojmë se ku qëndrojmë, çka po shpenzojmë dhe, më e rëndësishmja, për çka po shpenzojmë”, ka thënë Kurti në fjalën e tij.

Kurti ka theksuar se drafti i programit qeverisës i cili ka 41 faqe, derivon nga marrëveshja e koalicionit LV-LDK. “Ky program qeverisës pasqyron orientimet e përgjithshme të qeverisë, qasjen dhe parimet, prioritetet dhe

iniciativat si dhe vendimet që do të merren për ta përmirësuar gjendjen në vend në të gjitha fushat e përgjegjësisë”, ka deklaruar Kurti. Ai ka shtuar se qeveria nën drejtimin e tij do të jetë një qeveri e cila planifikon dhe analizon para se të ekzekutojë vendime e të realizojë punime, e cila promovon sundimin e ligjit, që redukton shpenzimet financiare, përmirëson menaxhimin e financave publike dhe

menaxhimin e ndërmarrjeve publike, që modernizon administratën publike dhe rritë transparencën e llogaridhënien. Kurti ka pohuar se synim i qeverisë është anëtarësimi në NATO, duke paralajmëruar se do të investojnë në mbrojtje që të rriten kapacitetet e FSK-së. Ai ka theksuar se shërbimi i jashtëm duhet të rishikohet në mënyrë që të garantojë përfaqësim të denjë për republikën. “Njohjet dhe anëtarësimet në organizata

ndërkombëtare janë prioritet për shtetin tonë. Anëtarësimi në BE mbetet prioritet, kurse dialogu me Serbinë të jetë mirë i përgatitur e parimor për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura”, ka thënë Kurti, duke shtuar se mërgata do të jetë edhe brenda qeverisë. “Barrierat e votimit jashtë dhe të mësimin në gjuhën shqipe do të lehtësohen si dhe do të rritet komunikimi dhe bashkëveprimi”, është shprehur Kurti.

Kërkohet që viti 2021 të shpallet vit i personave me aftësi të kufizuara

Në një fjalë rasti kryeministri Albin Kurti ka thënë se zyrat e qeverisë do të jenë gjithmonë të hapura për personat me nevoja të veçanta. “Është e domosdoshme që ata të cilët i kanë nevojat më të madha të ndihmohen më së shumti. Bëhet fjalë për njerëz me nevoja të veçanta të shoqërisë sonë të cilët e kanë jetën më të vështirë dhe ne si pjesëtarë të të njëjtit shtet do të duhet që ta dëshmojmë solidaritetin.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 MARS - Në sheshet e Prishtinës të dielën është zhvilluar marshi me moton “Mos ma kufizo lëvizjen” që kishte për qëllim vetëdijesimin e shoqërisë për mungesën e infrastrukturës në Kosovë për personat me aftësi të kufizuara. “Ku shkel këmba jote, të shkel rrota jeme”, “Edhe unë mundem nëse kam qasje” dhe “Na kështu lëvizim”. Ishin disa nga thirrjet e marshuesve të përdoruesve të karrocave. Drejtori i Handikos-it, Afrim Maliqi, ka thënë se liria e lëvizjes është fundamentale për secilin. Sipas tij, deri 15 për qind e popullatës, sipas OBSh-së, mund të preken nga kufizimet. “Karrocet janë një ndër pajisjet më të përdorura për personat me vështirësi në lëvizje, mirëpo mungesa e qasjes në hapësira publike, rrugë, trotuare, mohon fshehurazi lëvizjen e tyre. Rekomandojmë që Kuvendi i Kosovës të shpallë me rezolutë vitin 2021 për personat me aftësi të kufizuara”, ka thënë Maliqi. Në një fjalë rasti kryeministri Albin Kurti ka thënë se zyrat e qeverisë do të jenë gjithmonë të

hapura për personat me nevoja të veçanta. “Është e domosdoshme që ata të cilët i kanë nevojat më të madha të ndihmohen më së shumti. Bëhet fjalë për njerëz me nevoja të veçanta të shoqërisë sonë të cilët e kanë jetën më të vështirë dhe ne si pjesëtarë të të njëjtit shtet do të duhet që ta dëshmojmë solidaritetin. Në botë kemi pafund raste ku njerëz me karrocë i kanë dhënë dije dhe leadership botës. Dy prej këtyre shembujve janë shkencëtari Stephen Hawking dhe ish-presidenti amerikan Franklin Roosevelt. E dimë se ekziston një strategji e organizatës Handikos për vitin 2018-2022 dhe një tjetër e shtetit për vitin 2018-2020. Ne duhet t'i marrim rezultatet e këtyre strategjive dhe të analizojmë se çfarë ka shkuar mirë dhe çfarë ka munguar në mënyrë që ta kemi një planifikim që i ka parasysh objektivat dhe përvojën e juaj jetësore”, ka thënë Kurti. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka kujtuar një fjali të ish-presidentit amerikan Franklin Delano Roosevelt. “Gjëja e vetme nga e cila duhet të kemi frikë është vetë frika. Me këto fjalë i ishte drejtuar



popullit të tij, presidenti amerikan Franklin Delano Roosevelt. Në kulmin e karrierës së tij politike, presidenti Roosevelt do të diagnostikohet me një sëmundje, e cila do ta mbante në karrocë deri në fund të jetës. Shumëkush i kishte thënë se karriera e tij politike kishte marrë fund. Por, presidenti Roosevelt mendonte ndryshe. Ai

do të gjente një vendosmëri të çeliktë për të vazhduar para. Për presidentin amerikan sëmundja e cila e la të palëvizshëm ishte veç sprovë ndër zjar, e cila do ta testonte karakterin e tij për sfidat që do t'i vinin më vonë. Disa vite më vonë, pas tejkalimit të mijëra vështirësive, ai do të zgjidhej president i ShBA-së dhe do të mbetej në histori si një ndër

presidentët më të suksesshëm. Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Përdoruesve të Karrocës, e sollëm shembullin e presidentit Franklin Roosevelt si frymëzim për ta mundur frikën. Ne s'mund të zgjedhim se çfarë sfida na sjellë jeta, por ne zgjedhim se si t'u qasemi atyre: me frikë ndaluese, apo me shpresë rrezatuese”, ka deklaruar Osmani.

Sot hidhet shorti për renditjen e kandidatëve për kryetar të Podujevës

PRISHTINË, 1 MARS - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se sot (e hënë) bëhet tërheqja e shortit për renditjen e kandidatëve dhe subjekteve politike në fletëvotim për zgjedhjen e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës. Ai ka thënë për “Epokën e re” se KQZ-ja i ka kryer të gjitha përgatitjet për këto zgjedhje që do të mbahen më 15 mars. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer përgatitjet ligjore dhe teknike për ta organizuar tërheqjen e shortit për renditjen e kandidatëve dhe

subjekteve politike në fletëvotim e këtyre zgjedhjeve të cilat do të mbahen më 15 mars. Ky aktivitet është paraparë që të mbahet gjatë ditës së hënë, më 2 mars dhe janë të ftuar përfaqësuesit e subjekteve politike të cilat janë certifikuar nga KQZ-ja për të marrë pjesë në këto zgjedhje”, ka thënë Elezi. Ai ka treguar se fushata zgjedhore për këto zgjedhje do të mbahet nga data 3 deri më 13 mars. Kandidatë për kryetar të Komunës së Podujevës janë: Nexhmi Rudari (LDK), Shpejtim Bulliqi (LV) dhe Naim Fetahu (PDK).





FLET PËR “EPOKËN E RE”, ARIAN ZEKA

Kosova jep mesazh negativ për investitorët e huaj nëse ndërpritet marrëveshja për TC ‘Kosova e re’

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka kërkuar nga qeveria e re dhe Kuvendi që të ndjekin një agjendë dinamike të zhvillimit ekonomik, e cila do ta mundësojë fuqizimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Zeka ka folur edhe për taksën 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjës si dhe për termocentralin “Kosova e Re”. Ai ka thënë se taksa 100 për qind është në kundërshtim me zotimet që Kosova ka dhënë edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë si dhe me ambiciet për integrim në BE, por edhe për shkak se është kërkuar në vazhdimësi heqja e saj nga ShBA-ja. Ndërkaq ka pohuar se Oda Ekonomike Amerikane mbështet projektin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”, duke shpresuar se marrëveshja me “Contour Global” nuk do të ndërpritet për faktin se do të përçonte mesazh të keq për investitorët e tjerë të huaj

**EPOKA
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 MARS - Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se qeveria e re së bashku me Kuvendin duhet ta ndjekin një agjendë dinamike të zhvillimit ekonomik, e cila do ta mundësojë fuqizimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Duke folur për taksën 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, ai ka theksuar se

Kosova duhet të veprojë në uniformitet sa i përket kësaj çështje “për shkak se tarifa është në kundërshtim me zotimet që Kosova ka dhënë me nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë si dhe me ambiciet për integrim në Bashkimin Evropian, por edhe për shkak se është kërkuar në vazhdimësi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, ka thënë Zeka në intervistën dhënë për gazetën “Epoka e re”. Ai ka pohuar se Oda Ekonomike Amerikane mbështet projektin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” për shkak të nevojës për kapacitete të reja

energjetike për t'i plotësuar kërkesat për energji elektrike. Ai shpreson që marrëveshja me “Contour Global” nuk do të ndërpritet. “Shpresoj se marrëveshja nuk do të ndërpritet, meqë do të humbeshin kot shumë vite të kaluara për këtë proces, por edhe për shkak se kjo do të përçonte mesazh të keq për investitorët e tjerë të huaj. Dhe krejt në fund, edhe për shkak se investitori është një kompani amerikane”, është shprehur Zeka.

Në këtë intervistë Zeka ka folur edhe për sfidat e të bërit biznes në Kosovë. Ai ka theksuar se Kosova ka legjislacion të mirë të harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por zbatueshmëria e ligjeve ka qenë gjithmonë kërkesë me prioritet nga ana e bizneseve. “Në këtë aspekt, nevojitet fuqizimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të administratës publike, e cila duket të jetë shpesh arsyeja për moszbatim të ligjeve, ose zbatim të gabuar të tyre”, ka deklaruar Zeka.

“Epoka e re”: *Z. Zeka, si e vlerësoni klimën e biznesit në Kosovë dhe cilat janë pritjet e juaja sa i përket aspektit ekonomik në qeverinë Kurti?*

Zeka: Vitin e kaluar mjedisi i të bërit biznes ka pësuar goditje të rënda për shkak të ndalimit të reformës legjislative, pjesërisht për shkak të dorëheqjes së qeverisë dhe vonesës në konstituimin e institucioneve të reja, por edhe për shkak të joefikasitetit të Kuvendit para dorëheqjes së qeverisë. Fatkeqësisht, edhe disa muaj pas konstituimit të Kuvendit agjenda legjislative s'ka lëvizur nga pika zero. Raporti i fundit i Bankës Botërore rangoi Kosovën për disa vende më poshtë. Në këtë moment, nuk besoj se raporti për vitin 2021 do të jetë më i mirë se ai i vitit të kaluar. Pritshmëritë nga kjo qeveri, sikur edhe nga çdo qeveri e re, janë të larta dhe shpresoj se pritshmëritë s'do të prodhojnë zhgënjim. Qeveria e re së bashku me Kuvendin duhet të ndjekin një agjendë dinamike të zhvillimit ekonomik, e cila do ta mundësojë fuqizimin e sektorit privat, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

“Epoka e re”: *Ndërkohë që kishit një vizitë në ShBA, sa janë të interesuara bizneset atje për të investuar në Kosovë?*

Zeka: Nuk është fshehtësi, meqë është folur shumë tashmë për këtë, që vendi ka dështuar në promovimin e mirëfilltë të potencialeve ekonomike para investitorëve të huaj dhe rrjedhimisht ka dështuar t'i materializojë reformat në mjedisit e të bërit biznes para disa viteve me rritje të investimeve të huaja direkte. Në sytë e investitorëve të huaj

Kosova është vend me perceptim jo të mirë për shkak të problemeve politike, të brendshme dhe të jashtme, si dhe për shkak të perceptimit për korrupsion të lartë. Shumë prej këtyre perceptimeve ndërtohen nga mungesa e informatave të duhura për përparimin që Kosova ka shënuar, si dhe për potencialet e shumta që u ofrohen këtyre investitorëve. Tash interesimi i investitorëve amerikanë ekziston dhe ka ekzistuar edhe në vitet e kaluara, por që nuk është realizuar edhe për shkak se institucionet përkatëse të vendit nuk kanë ditur të përgjigjen si duhet, ose janë vonuar në veprimin e tyre. Dinamika e veprimit tregon jo vetëm besueshmërinë e tyre për Kosovën, por edhe parashikueshmërinë se me çfarë mund të përballen ata në fazat e mëvonshme të operimit, pas investimit në vendin tonë. Bizneset amerikane kanë interesim të vazhdueshëm për investime në sektorin e energjisë, por edhe për sektorë të tjerë më pak të promovuar në të kaluarën, siç është i industrisë së mbrojtjes.

“Epoka e re”: *Po ashtu kemi një dykuptueshmëri të koalicionit qeverisës sa i përket tarifës 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. Çfarë pasojash të raporteve shtetërore mund të ketë mosheqja e kësaj tarife, pavarësisht përsëritjes së përfaqësuesve të ShBA-së se duhet të hiqet?*

Zeka: Kosova duhet të veprojë në uniformitet për sa i përket tarifës ndaj dy shteteve të Ballkanit Perëndimor, për shkak se tarifa është në kundërshtim me zotimet që Kosova ka dhënë edhe me nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti të lirë si dhe me ambiciet për integrim në Bashkimin Evropian, por edhe për shkak se është kërkuar në vazhdimësi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përfitimet nga tarifa në aspektin politik nuk kanë prodhuar asnjë rezultat pozitiv, ndërsa në

aspektin ekonomik kanë qenë të kufizuara.

“Epoka e re”: *Po ashtu, sa i përket TC “Kosova e re” akoma s'kemi deklaratë zyrtare se a do të ndërpritet marrëveshja me “Contour Global”?*

Zeka: Oda Ekonomike Amerikane mbështet projektin e ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re” për shkak të nevojës për kapacitete të reja energjetike për t'i plotësuar kërkesat për energji elektrike, por edhe për shkak se do të mundësonte dekomisionimin e termocentralit “Kosova A”, i cili ka ndikim tejet negativ në mjedis. Shpresoj se marrëveshja nuk do të ndërpritet, meqë do të humbeshin kot shumë vite të kaluara për këtë proces, por edhe për shkak se kjo do të përçonte mesazh të keq për investitorët e tjerë të huaj. Dhe krejt në fund, edhe për shkak se investitori është një kompani amerikane.

“Epoka e re”: *Por brenda LV-së kemi disa përfaqësues tani të ekzekutivit që janë shprehur kundër këtij projekti?*

Zeka: Të gjitha partitë politike, e posaçërisht ato që janë pjesë e qeverisë, duhet t'i kuptojnë përfitimet nga ndërtimi i termocentralit, e çfarë është më e rëndësishmja, të demonstrojnë konsistencë ose vijimësi në qeverisje, sidomos në qeverisjen ekonomike. Nëse dikush ka pakënaqësi me dispozita të caktuara, mund t'i shfrytëzojë mekanizmat institucionalë për adresimin e atyre pakënaqësive. Vendimet nuk duhen bazuar në ideologji as partiake e as tjetër, por në analizë të hollësishme ekonomike.

“Epoka e re”: *Ju kishit takim me të dërguarin special të Trumpit për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell. E keni diskutuar këtë çështje?*

Zeka: Në takimin e ambasadorit Grenell është diskutuar vetëm për nevojën e një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e

cila do t'i hapte rrugë tërheqjes së investimeve të huaja dhe hapjes së mundësive për zhvillim të përsheptuar të tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Por, nuk është diskutuar për projekte të caktuara investive.

“Epoka e re”: *Dështimi i këtij projekti, çfarë pasojash mund t'i sjellë vendit?*

Zeka: Kosova do të humbiste vite të tëra dhe resurse të tjera të cilat janë shpenzuar përgjatë viteve për përgatitjen e projektit dhe finalizimin e tij. Do të vazhdonim të përballeshim me probleme për sa i përket sigurisë së furnizimit me energji elektrike, e sidomos në të ardhmen kur kërkesat për energji elektrike mund të rriten për shkak të rritjes potenciale të investimeve të huaja, si dhe të shtimit të aktiviteteve të brendshme industriale e ekonomike në përgjithësi. Në situatë të tillë, do të thellohej më tej varësia jonë nga importet, e cila ndikon direkt edhe në faturën që qytetarët dhe bizneset paguajnë për energjinë elektrike. Krejt në fund, vendi do të vazhdonte të përjetonte nivele të larta të ndotjes për shkak të zgjatjes së jetës së kapaciteteve të gjenerimit të energjisë elektrike që përdorin teknologji të vjetruar.

“Epoka e re”: *Cilat janë sfidat e të bërit biznes në Kosovë?*

Zeka: Kosova ka legjislacion të mirë në përgjithësi të harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por zbatueshmëria e ligjeve ka qenë gjithmonë kërkesë me prioritet nga ana e bizneseve. Në këtë aspekt, nevojitet fuqizimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të administratës publike e cila duket të jetë shpesh arsyeja për moszbatim të ligjeve, ose zbatim të gabuar të tyre. Në vazhdimësi ka raste kur dispozita të caktuara interpretohen në mënyrë të gabuar, në disfavor të sektorit privat. Në anën tjetër, prania e korrupsionit dhe mosefikasiteti i institucioneve përkatëse për

luftimin e tij janë faktorë që sfidojnë bizneset dhe gërryejnë mundësitë e një zhvillimi më të madh ekonomik. Trajtimi i kontesteve komerciale po ashtu lë shumë për të dëshiruar për shkak të kapaciteteve të kufizuara të sistemit gjyqësor, ndërsa kur flasim për kapacitetet, kjo nuk ka të bëjë vetëm numrin e gjyqtarëve, por edhe me profesionalizimin në trajtimin e kontesteve komerciale. Në këtë aspekt Oda Ekonomike Amerikane ka kërkuar krijimin e një Gjykate të veçantë Komerciale, e cila do t'i ndërtonte kapacitetet e duhura për trajtimin e kontesteve komerciale në mënyrë efikase.

“Epoka e re”: *Çfarë ankesash kanë bërë te ju bizneset të cilat i përfaqësoni sa i përket ambientit biznesor në Kosovë?*

Zeka: Komuniteti të cilin e përfaqëson Oda Ekonomike Amerikane ndan të njëjtat shqetësime nga ato të cekura më sipër. Do ta shtoja edhe praninë e madhe të ekonomisë joformale, e cila, me gjithë përpjekjet për luftimin e saj, mbetet në nivel të lartë. Kjo i pamundëson shtetit ta rrisë buxhetin, por edhe krijon mjedis të pabarabartë për bizneset që funksionojnë brenda kuadrit të ligjit. Ankesat e tjera kanë të bëjnë me vendime të pamenduara mirë dhe të padiskutuara me sektorin privat, të cilat cenojnë funksionalizimin e ekonomisë së tregut të lirë dhe operacionet e bizneseve. Së fundmi po përballemi me një iniciativë gjithnjë e në rritje të komunave të Kosovës, për ta kufizuar punën e bizneseve të dielën. Mund të tingëllojë gjykim subjektiv i Odës Amerikane, meqë përfaqëson bizneset e sektorit privat, por sinqerisht ndikimet do të ishin tejet negative për ekonominë e vendit për shkak të zvogëlimit të aktivitetit ekonomik. Bizneset do të detyroheshin t'u mbyllnin vendet e punës në një kohë kur krijimi i vendeve të reja të punës është i nevojshëm gjithkund.



Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë tejkalon planifikimet për 50 për qind

Prishtinë, 1 mars - Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Prishtinës për vitin 2019 ka tejkaluar pritjet buxhetore për 50 për qind, duke mbledhur 147 mijë euro nga 100 mijë të planifikuara. Lajmin e ka bërë me dije drejtori i Inspeksionit në këtë komunë, Adonis Tahiri. Ai ka treguar se këto të hyra janë mbledhur pas gjobave të shqiptuara nga inspektorët në terren e që janë kryesisht gjoba në trafik. “Sektori i rendit komunal është më i ngarkuari për nga përgjegjësitë për shkak se mbulon fusha të ndryshme, duke filluar nga mbikëqyrja e

transportit, qoftë mallrave, qoftë udhëtarëve, shumë shpesh kemi aksione për largimin e taksistëve ilegalë për largimin e shitësve ambulantë. Ne në secilin rast i largojmë nga komunikacioni ose ua konfiskojmë targat ose e konfiskojmë komplet automjetin dhe e shqiptojmë gjobën, pas pagesës së gjobës ne detyrohemi t'i kthejmë targat”, ka thënë ai për “Ekonomia Online”.

Tahiri ka thënë se kanë një bashkëpunim shumë të mirë me qytetarët dhe policinë pasi, sipas tij, kjo punë do të ishte e pamundur me numrin e vogël të

inspektorëve. “Kudo që haset në tentim për ndërtim pa leje ne i fillojmë procedurat dhe procedura e fundit kur pala nuk bindet është edhe vendimi i rrënimit, kështoj ne që nga viti i kaluar kemi zbatuar mbi 30 vendime të rrënimit dhe ka mbetur edhe një numër i vogël i tyre që do të gjejnë zbatim shumë shpejt. Në secilin rast jemi të përkrahur maksimalisht edhe nga Policia e Kosovës në mënyrë që për çfarëdo lloj rezistence brenda zbatimit të atij vendimi ta kemi edhe përkrahjen e saj”, është shprehur Tahiri.



Kurti shkon për ngushëllime në familjen Kelmendi: Qerimi u vra nga ata që nuk e duan atdheun

PEJË, 1 MARS (ER) - Të shtunën i është dhënë lamtumira e fundit ish-ushtarit të orëve të para të UÇK-së, Qerim Kelmendi, i cili është vrarë në mënyrë misterioze të enjten e javës së kaluar. Në ceremoninë e varrimit, e cila është zhvilluar në Kompleksin Memorial “Dëshmorët e Kombit” në Gllogjan, kanë marrë pjesë ish-bashkëluftëtarë të Kelmendit, përfaqësues të institucioneve, qytetarë dhe familjarë. Një ditë pas ceremonisë së varrimit, të dielën kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë homazhe te varri i Qerim Kelmendit,

ndërkaq pas homazheve Kurti ka shkuar për ngushëllime në familjen Kelmendi. Me këtë rast, Kurti ka thënë se Qerimi Kelmendi do të mbetet përherë në kujtimin tonë si luftëtar i lirisë. “Baba Haxha dhe nëna Nuriye nuk kanë mundur të mendojnë e as paramendojnë që djali të cilin e kishin edukuar për çlirim e atdhe do t’u vritet dy dekada pas çlirimit nga dora vrastare që s’e do atdheun. Qerimi do të mbetet përherë në kujtimin tonë si luftëtar i lirisë, e liria nuk vritet”, kanë qenë fjalët e Kurtit në librin e zisë së familjes Kelmendi.

Në Prizren kryhen kontrole pa pagesë për sëmundjet e traktit urinar

PRIZREN, 1 MARS (ER) - Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren kanë ofruar kontrole të përgjithshme mjekësore (check-up) pa pagesë për sëmundjen e traktit urinar.

Në këto kontrole janë përfshirë vizita specialiste, analizat laboratorike (CRP, Hemogram, Urea, Kreatinina, Urina, Jonogrami), tumormarkerët (PSA,

AFP) dhe ultrazëri i organeve urinare dhe prostatës.

Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Visar Shehu, ka thënë se analiza e jonogramit po ofrohet për herë të parë nga laboratorit i QKMF-së, ndërsa praktika e kontrolleve check-up pa pagesë do të vazhdojë edhe në të ardhmen për sëmundje të tjera të caktuara. Për kontrollet check-up të sëmundjes së traktit urinar janë paraqitur rreth 80 pacientë.



NE DHE AMERIKA

Kjo fazë delikate në të cilën ndodhen marrëdhëniet tona me Amerikën kërkon më shumë vëmendje dhe zgjuars, mbi të gjitha mendim publik i cili do të ishte i dobishëm edhe për vendimmarrjen politike



Mehmet PRISHTINA

Kornizat politike të mendimit publik në Kosovë janë ende të ngushta për të përballuar sfida të rënda që vijnë si rezultat i trysnive të ndryshme që vijnë nga jashtë. Aktualisht Kosova po përballlet me presionin për ta hequr taksën 100 për qind, ndërkohë që opinioni publik lidhur me këtë temë nuk ka ndërtuar ndonjë kauzë të veten. Lavjerrësi i mendimit publik lëviz varësisht nga disponimi politik që artikulojnë strukturat e caktuara partiake. Por, ende nuk e kemi një masë kritike që do të ishte e pavarur nga politika e ditës, e që do të përfaqësohej kryesisht nga njerëz të pavarur dhe me autoritet të pakontestueshëm moral e njerëzor. Në mungesë të kësaj mase kritike, ne sot kemi një mendim publik që gjykon bardh e zi, i cili nuk është rezultat i ndonjë analize paraprake, por më tepër është rrjedhojë e kontekstit politik. Edhe presioni për heqjen e taksës 100 për qind pa kushte që po kërkohet nga qeveria Kurti nuk ka ndonjë oponencë të

mirëfilltë mendimi e veprimi qytetar. Kjo oponencë tani për tani vjen vetëm nga politika, por edhe ajo nuk është unike, kurse mungon totalisht mendimi i intelektualëve, i profesorëve universitarë, i akademikëve, i artistëve, i shkrimtarëve etj. Akademia e Shkencave dhe Arteve, bie fjala, nuk debaton fare për këto tema të ndjeshme, të cilat, edhe pse janë të karakterit politik, ato megjithatë tangojnë interesat vitale të çdo qytetari. E ndodhur vetëm, pa një mendim përcjellës intelektual e profesional të shoqërisë, politika e ka vështirë të marrë qëndrime të prera, për arsye se ata që janë zgjedhur për ta udhëhequr shtetin, kanë detyrim ndaj votuesve që t'i realizojnë objektivat programore, por edhe të tregojnë sens kooperativiteti me komunitetin ndërkombëtar. Një situatë e tillë delikate e bën politikën më të vëmendshme në vendimmarrje, kurse pasojat janë më të mëdha nëse nuk analizohen të gjitha hapat që duhet të ndërmerren. Në anën tjetër, intelektualët e fushave të ndryshme nuk e kanë këtë barrë përgjegjësie, prandaj edhe nuk janë të obliguar të mbajnë qëndrime luajaliste kundrejt një problematike të caktuar. Si të shpjegohet ky indiferentizëm i elitës intelektuale e shkencore të

Kosovës ndaj çështjeve të mprehta që bien mbi kurrizin e secilit dhe pse kjo elitë tregohet kaq e matur në shpalosjen e qëndrimeve publike? Pse elita intelektuale e shkencore e Kosovës nuk po e shfaq mendimin e vet të hapur se çfarë qëndrimi duhet të mbaj qeveria aktuale kundrejt presionit për heqjen e taksës 100 për qind? Si të shpjegohet gjithë ky hezitim i akademikëve, i shkrimtarëve, i artistëve, të cilët po sillen sikur të ishin partizanë të dëgjueshëm të partive politike? Një elitë e mirëfilltë intelektuale do të duhej t'ia sqarojë popullit natyrën e presioneve që vijnë nga jashtë, qofshin ato edhe nga Amerika. Sepse një elitë e mirëfilltë sigurisht do të duhej të dijë të bëjë dallimin në mes të Amerikës si shtet dhe si komb dhe administratës së presidentit cilido qoftë ai. Lidhja e përhershme emocionale me ShBA-në burimin e ka në konceptin liridashës të shqiptarëve për ta çmuar mikun që ta shpëtojë jetën në momentet më kritike. Edhe atëherë, në vitin 1919, kur presidenti Wilson vuri veto ndaj përfaqësuesve diplomatikë në Konferencën e Paqes në Paris, për t'i shpëtuar tokat shqiptare nga copëtimi i mëtejshëm, por edhe në vitin 1999, kur presidenti Klinton bashkë me gjeneralin Clark dhe sekretaren e shtetit, Ollbrajt, aktivizuan diplomacinë ndërkombëtare për ndërhyrje ushtarake ndaj makinës vrastare të Millosheviqit, shqiptarët e kishin besimin e palëkundur tek Amerika dhe kjo i bën ata shumëfish të përgjegjshëm ndaj çdo sugjerimi a kërkesë që vjen

nga Uashingtoni. Kjo përgjegjësi nuk është aspak më e vogël edhe tani kur nga qeveria Kurti po kërkohet heqja e taksës 100 për qind si parakusht për vazhdimin e bisedimeve me Serbinë, që do të duhej të përfundonte me një marrëveshje finale në me të dy shteteve. Por çuditërisht kemi një heshtje totale nga shtresa intelektuale, së cilës po i mungon guximi për të shprehur publikisht qëndrimin e vet lidhur me këtë çështje. Kjo po ndodhë në kohën kur Kosova ka disa universitete publike e private, ka Akademi të Shkencave e Arteve, ka shoqata të artistëve shkrimtarëve, ka media e asociacione qytetare të cilët njëzëri kanë zgjedhur heshtjen si metodë, kurse konformizmin si sjellje, që në fund të fundit tregon papjekurinë e mjaftueshme të kësaj shtrese shoqërore, e cila nuk e ka për detyrë të heshtë, por ta shprehë hapur mendimin, madje edhe atëherë kur dikujt nuk i pëlqen. Intelektualët duhet të shprehin ndonjë mendim edhe nëse nuk i pëlqen administratës Amerikane, sepse vetë Amerika është ngritur dhe zhvilluar mbi parimin e demokracisë së hapur dhe mendimit të lirë. Nëse ndjekim me vëmendje mediat amerikane, do të vërejmë se jo pak vendime të presidentit Trump shoqërohen me kritika e mospajtime nga komunitetet e ndryshme të intelektualëve, juristëve, ekonomistëve, shkencëtarëve etj. Por, ky fakt nuk e bën më të dobët Amerikën. Përkundrazi, vetëm në Amerikë shteti është i fortë kur njerëzit i shprehin lirshëm mendimet e tyre pa u frikuar për

pasojat që mund të kenë. Nisur nga kjo logjikë, është shumë normale që të kërkojmë të njëjtin model të mendimit publik edhe te ne në Kosovë, ku njerëzit e fushave të ndryshme do t'i shprehnin pikëpamjet e tyre që jo gjithmonë janë në të njëjtat valë me qëndrimet e presidentit amerikan. Kjo assesi nuk e dobëson miqësinë tonë me Amerikën, por përkundrazi e bën më të qëndrueshme lidhshmërinë me ShBA-në, e cila bazohet mbi respektimin e sovranitetit dhe dinjitetit të dyanshëm. Vetëm një Kosovë dinjitoze, e papërkulur ndaj presioneve të jashtme, është edhe një partner i sigurt i ShBA-së në rajon, sepse shqiptarët dhe Kosova interesat jetike i kanë ngushtë të lidhura me ShBA-në. Ky është një fakt i mjaftueshëm për ta kuptuar esencën e besnikërisë që kanë shqiptarët ndaj Amerikës, që në asnjë instancë nuk do të duhej të përkthehej si vasalitet. Lufta disashekullore e Kosovës për ta fituar lirinë dhe pavarësinë pati rëniet dhe ngritjet e veta, por në historinë më të re është për t'u evidentuar kthesa që ndodhi në vitin 1999, kur kjo luftë shekullore u kurorëzua me çlirimin e Kosovës nga okupimi serb. Shqiptarët janë të vetëdijshëm se kjo kurorë do të mbetej nëpër muze, sikur të mos ishte dora e fortë e Amerikës e cila vulosi njëherë e përgjithmonë procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Edhe kjo fazë delikate në të cilën ndodhen marrëdhëniet tona me Amerikën kërkon më shumë vëmendje dhe zgjuars, mbi të gjitha mendim publik i cili do të ishte i dobishëm edhe për vendimmarrjen politike.

Të rinjtë e Gjilanit aftësohen për ndikim social



GJILAN, 1 MARS (ER) - Në Gjilan është hapur punëtorja treditore për ndikim social-Upshift, në të cilën do të marrin pjesë dhjetë

grupe të nxënësve të klasave të dhjeta. Pasi e ka shpallur të hapur këtë punëtori, drejtoresha e Kulturës, Rinisë

dhe Sportit, Deniza Limani, ka falënderuar "IPKO Foundatin" dhe UNICEF-in për bashkëpunimin me këtë

komunë. Ajo ka thënë se së bashku me partnerët përmes këtij programi shumë të rinj do të aftësohen dhe po u jepet

mundësia që të japin ide dhe, në të njëjtën kohë, të ndërmarrin hapa konkretë në çështje të ndryshme.

Joe Biden fitoi zgjedhjet paraprake në Karolinën e Jugut

WASHINGTON, 1 MARS – Ish-nën-presidenti Joe Biden, shënoi fitore të thellë të shtunën në zgjedhjet paraprake të demokratëve në Karolinën e Jugut, një hap thelbësor për të para zgjedhjeve të së martës së ardhshme në 14 shtete, që njihet si “Super e marta”. Pas disa paraqitjeve të zbehta të Bidenit në zgjedhjet paraprake në tre shtete, analistët

parashikuan se fushata e tij do të merrte fund nëse ai nuk fitonte në Karolinën e Jugut, ku siguroi mbështetjen e fortë nga afrikano-amerikanët, të cilët paraqesin një përqindje të madhe të votuesve në këtë shtet. Bideni jo vetëm që mundi senatorin e Vermontit, Bernie Sanders, i cili hyri në garën e Karolinës së Jugut si favorit në

shkallë vendi, por ai e bëri këtë me lehtësi, duke u treguar votuesve se ai ende ka fuqinë që të sfidojë Sandersin.

Me 99 për qind të votave të numëruara, Bideni doli i pari me 48.6 për qind, Bernie Sanders i dyti me 19.9 për qind dhe miliarderi Tom Steyer, i treti me 11.3 për qind të votave.



SHBA-ja dhe talibanët nënshkruajnë marrëveshje për t'i dhënë fund konfliktit në Afganistan

Sipas marrëveshjes historike të nënshkruar mes palëve, talibanët janë pajtuar që t'i ndalin sulmet dhe të mos lejojnë grupin terrorist, Al-Kaida që të operojë në zonat që ata kontrollojnë, kurse SHBA-ja është pajtuar që t'i tërheqë trupat nga Afganistani brenda 14-muajsh, nëse militantët talibanë i përmbahen marrëveshjes



KABUL, 1 MARS - Shtetet e Bashkuara dhe talibanët kanë nënshkruar marrëveshje historike, që ka për qëllim dhënien fund të konfliktit në Afganistan.

SHBA-ja është pajtuar që t'i tërheqë trupat nga Afganistani brenda 14-muajsh, nëse militantët talibanë i përmbahen marrëveshjes.

Ky pakt është arritur pas nëntë raundeve të bisedimeve në mes të Shteteve të Bashkuara dhe talibanëve në Katar.

Aktualisht, në Afganistan janë 13 mijë trupa amerikane.

Talibanët po ashtu janë zotuar se do të zhvillojnë bisedime direkte me qeverinë në Kabul, ka njoftuar rfe.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo dhe liderët talibanë, ishin të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes në Doha të Katarit. “Ne ende jemi në fillim”, tha sekretari Pompeo para nënshkrimit të marrëveshjes.

“Ulja e konsiderueshme e dhunës do të krijojë kushte për paqe”, tha ai.

Sekretari Pompeo shtoi se afganët duhet të jetojnë në paqe

dhe prosperitet dhe t'i respektojnë të drejtat e grave, teksa SHBA-ja duhet të sigurohet se nuk do të ketë kërcënim terrorist nga ky vend.

Duke folur në Kabul, Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mark Esper tha se SHBA-ja nuk do të hezitojë ta anulojë marrëveshjen, nëse talibanët nuk i përmbahen asaj.

“Nëse talibanët i përmbahen marrëveshjes, SHBA-ja do të nisë reduktimin e forcave”, tha ai, duke e quajtur arritjen e kësaj marrëveshjeje “një moment të rëndësishëm në procesin e paqes”.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se kjo marrëveshje është “hapi i parë drejt paqes së qëndrueshme”.

“Rruga drejt paqes është e gjatë dhe e vështirë. Ne duhet të përgatitemi për pengesa, nuk ka rrugë të lehtë të paqes, por ky është një hap i parë i rëndësishëm”, tha Stoltenbergu për gazetarët në Kabul.

Bashkimi Evropian mirëpriti marrëveshjen e paqes duke thënë se këta janë “hapat e parë të rëndësishëm” drejt zgjidhjes së përhershme të konfliktit në

Afganistan.

“Mundësia e tanishme për të ecur drejt paqes nuk duhet të shpërdorohet”, tha shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell përmes një deklarate, duke shtuar se “pa vonesë”, duhet që të gjitha fraksionet politike dhe grupet e shoqërisë të përfshihen në negociatë.

“Konflikti ka nevojë për një zgjidhje politike që respekton të drejtat e njeriut, të drejtat e grave dhe adreson të gjitha çështjet”, tha ai.

Sipas marrëveshjes, talibanët janë pajtuar që t'i ndalin sulmet dhe të mos lejojnë grupin terrorist, Al-Kaida që të operojë në zonat që ata kontrollojnë.

Nënshkrimi i marrëveshjes vjen një javë pasi forcat e udhëhequra nga SHBA-ja dhe talibanët u pajtuan që të reduktojnë dhunën.

Deri më tani, talibanët kishin

refuzuar që të zhvillonin bisedime direkte me Qeverinë afgane, duke e quajtur atë “kukull” të Perëndimit.

Mirëpo tani, pasi që talibanët pritët të përfshihen në bisedime me liderët afganë, Pompeo ka pasur një porosi.

“Ushtroni durim edhe kur ka zemërim.

Nderoni llojllojshmërinë e shtetit tuaj dhe bëni vend për të gjitha pikëpamjet. Qeveritë afgane në të kaluarën kanë dështuar sepse nuk ka pasur mjaftueshëm gjithpërfshirje”, tha ai.

Ai ka bërë këto deklarata meqë bisedimet ndërmjet Qeverisë afgane dhe talibanëve ende duket se do të jenë të vështira që të mbahen, pasi shumë persona në Kabul dyshojnë në sinqeritetin e ekstremistëve dhe aftësisë së tyre për të kontrolluar të gjithë luftëtarët e grupeve militante.

Forcat e koalicionit të udhëhequr nga SHBA-ja pushtuan Afganistanin në vitin 2001 dhe larguan nga pushteti talibanët, pasi grupi militant refuzoi që ta dorëzonte terroristin e Al-Kaidës, Osama bin Laden.

Që atëherë, rreth 2,400 ushtarë amerikanë janë vrarë gjatë luftimeve së bashku me dhjetëra-mija ushtarë afganë, luftëtarë ekstremistë dhe civilë.

Më 28 shkurt, presidenti i Shteteve të Bashkuara tha se marrëveshja me talibanët është rruga e vetme për paqe të qëndrueshme në Afganistan.

“Nëse talibanët dhe Qeveria e Afganistanit u përmbahen zotimeve të tyre, ata do të kenë në rrugë të fuqishme drejt dhënies fund të luftës në Afganistanit dhe kthimit në shtëpi të trupave tanë”, tha Trumpi.

Lëvizja OLaNO ka fituar zgjedhjet në Sllovaki

BRATISLAVË, 1 MARS - Lëvizja antikorrupsion Njerëzit e Zakonshëm (OLaNO), sipas sondazheve, ka dalë e para në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 29 shkurt në Sllovaki.

Zgjedhjet parlamentare të 29 shkurtit ishin zgjedhjet e para të mbajtura që prej se u vra gazetari Jan Kuciak, gjë e cila shkaktoi protesta masive kundër korrupsionit.

Lideri i partisë OLaNO, Igor Matovič duket se ka arritur që të shndërrojë zemërimin e

publikut për vrasjen e Kuciak dhe të fejuarës së tij, Martina Kunirova, në fitore të madhe në zgjedhje.

“Ne do të përpiqemi të krijojmë qeverinë më të mirë që ka pasur ndonjëherë Sllovakia, me ndihmën e liderëve të tjerë të opozitës demokratike”, u tha Matovič gazetarëve, pasi u shfaqën rezultat e sondazheve.

“Ishte vdekja e Jan Kuciak dhe Martina Kunirova që zgjoi Sllovakinë”, shtoi ai.

Sipas agjencisë së son-

dazheve, Focus, OLaNO ka fituar 25,8 për qind të votave, ndërkaj parti e kryeministrit aktual, Peter Pellegrini, Partia Socialdemokrate, ka fituar 14,9 për qind të votave.

Ndërkaj, sondazhi i kryer nga Median.sk, ka thënë se OLaNO ka fituar mbi 25 për qind të votave, ndërkaj, parti e Pellegrini 13,9 për qind.

Analistët thonë se nëse këto sondazhe janë të sakta dhe OLaNo fiton më së shumti vota, kjo parti do të krijojë koalicion me disa parti opozitare.



Ata thanë se Matovič, 46-vjeçar, do të bëhet kryeministri i ardhshëm i vendit, nëse ai arrin të krijojë koalicionin qeverisës.

Vrasja e gazetarit Kuciak dhe të fejuarës së tij, shkaktuan protesta të mëdha që çuan në dorëheqjen e kryeministrit Robert Fico.



GRENNELL DHE KURTI



Ismet SYLEJMANI

Emri me i ri, më i përmendur e më i fuqishëm është Ambasadori i SHBA-së Richard Grenell, i cili bashk me Kryeministrin Albin Kurti, aktualisht janë personalitetet më të fuqishme në Kosovë dhe jo vetëm, të cilët e dominojnë çdo gjë që dëgjohet e që shkruhet! I pari sikur edhe dihet vjen dhe ndërmjësion në mes të Kosovës dhe Serbisë!

Është i dërguar special i Presidentit të SHBA-së Donald Trump!

Boterisht dihet, se Ambasadori Grenell, nga fuqia që përfaqëson, me një të goditur do të zgjidhte të gjitha çështjet e pazgjidhura të Kosovës me Serbinë, çështje të cilat janë të pazgjidhura jo vetëm që nga pas lufta ne mes shqiptarëve dhe serbëve!

I dyti, Kryeministri Kurti është befasia më e madhe e zgjedhjeve në Kosovë, i cili fitoi zgjedhjet

dhe po drejton me Qeverinë e Republikës së Kosovës!

Kryeministri Albin Kurti me ardhjen e Tij në pushtet, ka provokuar të gjitha pushtetet politike në regjion e më gjerë!

Fitorja e Tij, është paralajmerim se do të vijë klasë e re e të rinjëve në politikë dhe kjo frymë do të shkojë jo vetëm duke u rritur e duke marrë përmasa të mëdha, por edhe do të shkaktojë tërmete politike dhe përmbysje të pushteteve!

Kosova dhe Serbia, të dy shtetet, të dy kampet politike, të dy palët në dialog, pavarësisht nga retorikat e ashpera dhe nga konfliktet që kanë pasur në të kaluarën, e kanë një dicka të përbashkët: AMERIKEN!

Kosova dhe shqiptarët e kanë një rrespekt të pafund ndaj Amerikës!

Kurse serbet e kanë një urrejtje të pafund ndaj Amerikës!

Pra respekti ndaj Amerikës i Kosovës dhe i Serbisë dallon në esencë!

Kosova e ka dashurinë e madhe dhe të pakontestuar ndaj Amerikës dhe nuk e fshehë, por e ka publike, prandaj edhe e admiron superfuqinë botërore!

Serbia e urren Amerikën, e ka armike Amerikën, por nga frika bëhet sikur e admiron, gjithashtu edhe Amerika nuk beson në miqësinë me Serbinë, sepse

dihet se Serbia e ka aleate kryesore dhe strategjike Rusinë!

Por një është e saktë që Ambasadori Grenell gjithnjë e më shumë po bëhet i pranishëm në Kosovë e Serbi e rrjedhimisht edhe në Ballkan, kjo është shprehje e prezencës së fuqishme të SHBA-së!

Këto dy personalitete të mëdha në kohën kur po e dominojnë skenën politike në Kosovë, janë me të fuqishmit, janë me të pranishmit, janë me të lakuarit e me të përfolurit në të gjitha mediat, në të gjitha analizat e në të gjitha debatet, janë kudo e janë për të gjitha kombinimet! Ambasadori Grenell dhe Kryeministri Kurti, njëri i deleguar i SHBA-së dhe tjetri fitues i zgjedhjeve, jane timonieret e rinj te Kosoves në vitin 2020 e tutje!

Këta të dytë janë të përkohshëm, sepse edhe pas tyre do të vijnë udhëheqës të tjerë, por Kosova dhe Amerika janë e do të jenë aleate e mike e përgjeshme!

Dalja e këtyre dyve në skenë nuk është e rastit as e çastit!

Për Grenellin negociator në njërën anë është vendim i SHBA-së dhe në anën tjetër për Kurtin është vendim i dalur nga zgjedhjet e mbajtura të 6 Nëntorit, Nëntorit 2020 në Kosovë!

Ecja me hap të sigurtë e me suk-

ses e Kosovës varet jo vetëm nga këta të dy, por këta aktualisht janë aktoret kryesore, njëri i caktuar e i deleguar special nga Presidenti Amerikan dhe tjetri i zgjedhur me votë demokratike nga Populli i Republikës së Kosovës!

Taksa 100% dhe reciprociteti, shihet sikur i ndanë, por në fakt ajo i bashkon, sepse i bashkon lufta kundër të kqiave ndaj njerëzimit, i bashkon projekti euroatlantik për demokraci, i bashkon lufta për sundim të ligjit e për ligj zbatim, për antikorrupsion dhe për qeverisje demokratke!

Ambasadori Grenell e Kryeministri Kurti, aktualisht janë duke dominuar në skenë, sepse kane legjitimitet, dhe deri kurë do të jetë kështu mbetet të shihet, por shikuar nga ajo që dihet për Amerikën dhe për ata që e zbatojnë miqësinë me SHBA-në, ky dominim do të duhej të përfundonte në dobi të paqes në mes të Kosovës e Serbisë dhe në rajon!

Qendrimet dhe vendimet e tyre ndaj taksës kundër Serbisë, i kanë bërë edhe me atraktiv në opinion, edhe më të pranishëm e edhe më prezent te të gjitha shtresat e qytetareve!

Perspektiva është në anën e tyre, sepse përfaqësojnë dy shtete aleate të mëdha, që përfaqëso-

jnë fuqi të përmasave tepër të ndryshme e të pamatshme në mes tyre!

Kosova definitivisht nuk mundet pa Amerikën, por edhe Amerika nuk ecë përpara pa Kosovën, sepse Amerika ka dhënë shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe largimin e Serbisë pushtuese!

Amerika të bën faktorë në çdo kontinent që të gjendesh, por edhe nëse je kundër sajë e kundër proceseve progresive botërore, të defaktorizon çfardo fuqi që të keshë!

Amerika në favor të paqes e të funksionimit të rendit demokratik e të shtetit të së drejtës, të miqëson edhe me armiqtë më të mëdhenj e më të përбетuar, të cilët nën presionin e sajë, pësojnë metamorfozë rrënjësore!

Nëse je në rrugë të drejtë, Amerika të ndihmon të bëhesh i lirë e sovran, i pavaruar e demokratik, i pranuar e i njohur ndërkombëtarisht!

Kosova është një nga storiet e suksesit më të madh të SHBA-së! Kosova do të jetë ashtu siç dëshiron populli i sajë, që përmes bijëve e bijave të saj më të mira, ka luftuar e ka derdhur gjak për liri, ashtu si dëshiron aleati i sajë më i madh Amerika dhe ashtu siç dëshiron Zoti!

Prishtinë, 29 shkurt 2020!



(Fjalë e mbajtur në ekspozitën tematike “Kujtesa e Kosovës: Portrete të Adem Demaçit në pikturë dhe fotografi”, e organizuar nga Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, në Prishtinë, më 26 shkurt 2020, në ditëlindjen e 84-t të Adem Demaçit)

Të botohet vepra letrare dhe publicistike e Adem Demaçit në 40 vëllime

Selatin NOVOSELLA

Përshëndetje!

Na ka tubuar sot Adem Demaçi, ashtu siç na ka tubuar gjatë gjithë jetës së tij, qoftë me praninë e tij, qoftë pa praninë e tij fizike, për 28 vjet sa po vuante në burgjet serbe dhe jugosllave. Kështu do të na tubojë gjithnjë jeta e tij, shembulli i tij, sakrificat e tij, vepra e tij, misioni i tij historik, vizioni i tij politik, filozofia e tij jetësore, mendja e tij paravajtëse, testamenti dhe amaneti i tij. Trashëgimia poliedrike dhe polivalente e Adem Demaçit është kolosale. Në Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës, gjatë një pune të pandërprerë hulumtuese, janë grumbulluar, sistemuar dhe studiuar: 33 vepra të botuara dhe të

ribotuara të Adem Demaçit; 3 vepra të përkthyer nga letërsia botërore nga Adem Demaçi; 4 libra me intervista të Adem Demaçit; 5 romane të Adem Demaçit të përkthyer në italisht, në gjermanisht, në maqedonisht dhe 2 në esperanto; 31 monografi kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit; 497 libra në të cilat flitet edhe për Adem Demaçin; 125 CD me materiale të ndryshme të Adem Demaçit dhe për Adem Demaçin; 155 poezi kushtuar Adem Demaçit; 26 këngë kushtuar Adem Demaçit; 30 piktura dhe vizatime kushtuar Adem Demaçit; rreth 200 revista dhe gazeta, me shkrime të Adem Demaçit dhe për Adem Demaçin; rreth 10.000 faqe me dokumente arkivore, dorëshkrime të Adem Demaçit, programe politike, statute të

organizatave, intervista, fjalime, analiza, deklarata, letra të Adem Demaçit nga burgu etj. Gjatë kësaj pune hulumtuese, siç u tha më lartë, janë sistemuar edhe fotografi të panumërta, piktura dhe vizatime, një pjesë e të cilave janë prezantuar në këtë ekspozitë të titulluar “Kujtesa e Kosovës: Portrete të Adem Demaçit në pikturë dhe fotografi”, pikërisht në ditëlindje e 84 Bacës sonë të çmuar, Adem Demaçi. Në shekullin e njëzet Kosova i dhuroi historisë sonë kombëtare tri personalitete unike dhe të papërsëritshme: Hasan Prishtinën, ideatorin e lëvizjes irredentiste shqiptare, rrymë politike e lindur në jetën tonë kombëtare pas mbetjes së Kosovës dhe Viseve tjera jashtë trungut të atdheut tonë të shtrenjtë, Shqipëri; Adem

Demaçin - vazhduesin besnik të kësaj filozofie politike, siç do të thotë edhe ai vet me një rast, se: “Gjithë jetën e kam ndie veten një ushtar të vogël të Hasan Prishtinës”, kurse ne do të thoshim ushtar i madhe i Hasan Prishtinës, përfaqësuesi dhe - Adem Jasharin, realizuesin e projekteve të dy të parëve. Sa herë të përmendet romansieri i parë, i pjesës së letërsisë shqipe jashtë Shqipërisë së shtetëzuar, do të na kujtohet Adem Demaçi dhe romani i tij i famshëm “Gjarpërinjtë e gjakut”. Sa herë të përmenden fjalët e një të burgosuri politikë, të thëna para Gjyqit të Qarkut të Prishtinës, në janar të vitit 1959: “Po ju them edhe njëherë se, nëse Serbia dhe Jugosllavia vazhdojnë me këtë politikë ndaj shqiptarëve dhe nuk lejojnë që Kosova dhe viset tjera të

pushtuara nga Jugosllavia të bashkohen me shtetin anë, Shqipërinë, nuk do të ketë paqe as në Jugosllavi as në Rajon. Nëse Serbia vazhdon me këtë politikë, një ditë ajo do të bëhet shkaktare e shpartallimit të krejt Jugosllavisë dhe, në fund, do të mbetet edhe pa Kosovën!” do të na kujtohet Adem Demaçi, atëherë vetëm 23-vjeçar. Sa herë të përmendet kampioni i burgjeve të pushtuesit të shqiptarëve, burgje që zgjatin 28 vite, të mbajtura në Burgun e Pudujevës, të Prishtinës, të Mitrovicës së Sremit, të Nishit, të Pozharevcit dhe të Stara Gadishkës, prej të cilave do t'i vuaj 6 vite e gjysmë në qelitë nën dhe, plotësisht i vetmuar, gjithsesi do të na kujtohet Baca ynë i çmuar Adem Demaçi. Sa herë të ligështohemi, në udhëkryqet e jetës, do të na

kujtohet mendimi i artë i Bacit: “Jeta është një maratonë që, për të arritur në cak, duhet të vraposh, nëse nuk mund të vraposh atëherë ec, nëse nuk mund të ecësh atëherë shko në këmbë e duar!”

Sa herë të kujtojmë luftëtarin e betejave të panumërta, se me 100 plagë në trup e në shpirt, po vihej në kreun e udhëheqjes politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në luftën e fundit balllore Kosovë - Serbi, do të na kujtohet, gjithsesi, Baca ynë i shtrenjtë Adem Demaçi.

Sa herë që na zbehet dashuria ndaj Atdheut tonë, atdheut të gjithë shqiptarëve, Shqipërisë, duhet të na kujtohet dashuria dhe adhurimi i Adem Demaçit për Shqipërinë, të cilës, zakonisht, ai i drejtohej Nëna Shqipëri!

Sa herë që të kemi nevojë të dimë, se pas cilëve liderë dhe udhëheqës politikë të

rreshtohemi, duhet ta rikujtojmë porosinë lapidare të Adem Demaçit: “Ju lutem, mësohuni të shkoni pas ideve e jo vetëm pas individëve. Sepse individët mund të gabojnë, mund të sëmuren, mund të burgosen dhe mund të vdesin, kurse idetë nuk vdesin kurrë!”.

Për këto dhe për shumëçka tjetër duhet ta mbajmë të gjallë figurën e emblematike të Adem Demaçit. Brezat duhet të mësojnë për figurën e Bacës Adem. Figura e tij duhet të prezantohet në historinë e letërsisë shqipe, në Historinë e të gjitha niveleve të shkollave tona, në Kosovë, në Shqipëri dhe kudo që jetojnë shqiptarët. Shumica e njerëzve vdesin. Vetëm të rrallët ndërrojnë jetë, siç ka ndërruar jetë Baca ynë i dashur Adem Demaçi, më 26 korrik 2018. Andaj, Ai duhet të jetë pjesë e jetës sonë të përditshme.

Sa do të arrihet që Adem Demaçi, Heroi i Kosovës, i dekoruar nga presidenti i Kosovës, Jakup Krasniqi, Nderi i Kombit, i dekoruar nga presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, Doktor Nderi i Universitetit të Prishtinës, fituesi i Çmimit “Saharov”, dhe i çmimeve, dekoratave dhe shpërblimeve të panumërta, kombëtare dhe ndërkombëtare, të bëhet pjesë e jetës sonë, do të varret nga tre faktorë: një - nga bashkëveprimtarët e Bacit Adem, të cilët me kujtimet, evokimet dhe shkrimet e tyre do ta bëjnë atë që, për arsye që dihen, nuk mund ta bëjë askush tjetër; dy - nga institucionet e shkencës, të artit, të letërsia dhe të kulturës, duke e bërë jetën dhe veprën madhore të Adem Demaçit objekt të hulumtimeve, studimeve dhe botimeve të tyre dhe tre - do të varet nga

institucionet shtetërore të Kosovës, për themelimin e të cilave, Adem Demaçi kishte kontribuar pakufi. Ai, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, d.m.th., edhe për themelimin e institucioneve tona, vetëm nuk kishte vdekur dhe ringjallur.

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, me të drejtë, pret nga Qeveria e re e Kosovës që t'i marrë dy vendime. Një - që me akt të veçantë ta themelojë Institutin për Hulumtimin, Studimin dhe Publikim e veprimtarisë së të burgosurve politikë të Kosovë, që do të bartë emrin “Adem Demaçi”, siç e parasheh Ligji për Statusin e të Burgosurve Politikë, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës shumë vite më parë, dhe - dy që ta mbështes financiarisht projektin për botimin e veprave të zgjedhura të Adem Demaçit dhe për Adem Demaçin, në 40

vëllime.

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës ka bashkëpunuar me të gjitha Qeveritë e Kosovës deri tashti, për realizimin e projekteve të saja. Besojmë se, edhe me Qeverinë e re, do të vazhdojmë këtë bashkëpunim, me një ndajshtim se kryeministri Albin Kurti ishte ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Adem Demaçit, Përfaqësuesin e Përgjithshëm Politikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kohën më të vështirë për Kosovën, deri në burgosjen e tij në Burgun e Pozharevcit, ku Adem Demaçi i kishte vuajtur 10 vite burg të rënd, së bashku edhe me Skender Kastratin, Fehmi Baftiun etj.

Institutin me emrin e Adem Demaçit dhe botimin e kompletit të veprave të Adem Demaçit ia kemi borxh maratonmakut shqiptar.



Baleti Kombëtar i Kosovë me katër shfaqje për muajin mars

Baleti Kombëtar i Kosovës do t'i shfaq katër shfaqje gjatë muajit mars, shkruan KultPlus.com Siç duket Baleti Kombëtar i Kosovës edhe muajin mars do të ketë një aktivitet të konsiderueshëm. Ky institucion përmes një postimi në Facebook, Baleti Kombëtar i Kosovës ka publikuar shfaqjet	dhe oraret e tyre, të cilat janë si vijon: 05.03.2020 – Shfaqja “Pushimi i Kalorësve” Koreografia: Natalia Osipova Premiera 06.03.2020 – Shfaqja “Pushimi i Kalorësve”	Koreografia: Natalia Osipova Repriza e parë 12.03.2020 – Shfaqja “Pushimi i Kalorësve” Koreografia: Natalia Osipova 26.03.2020 – Shfaqja “Exil” Koreografia: Eno Peçi /KultPlus.com	
--	---	--	--



Mënyra si lexojmë tani

Nga Joseph BOTTUM

Për gati 300 vjet, romani ishte një nga format më të rëndësishme të artit, mbase më e rëndësishmja, kurse në botën moderne, mjeti me të cilin u përpoqëm t'ia shpjegonim veten pikërisht vetes tonë. Diçka e re hyri në art gjatë kalimit nga Mesjeta, nëpërmjet Rilindjes dhe lëvizjes së Reformacionit tek epoka moderne. Mund ta quajmë "kthim nga e brendshmja", pranimi gjithnjë e më shumë se jeta dhe drama e brendshme janë të vërteta, jo thjesht veprimtari të parëndësishme, të domosdoshme për të mbajtur bashkë trupin dhe shpirtin ndërsa luajmë jetën tonë të vërtetë në skenën e botës. Mendoni se sa e rrallë ishte drama e brendshme

më parë për romanin. Penelopa tjerri pak detaje nga jeta private krahasuar me gjendjen politike në mjedisin shtëpiak tek "Odisea", mbretëresha Dido nuk rrëfen për veten por për protagonistët e historisë tek "Eneida" kurse perëndesha e zemëruar Ishtar shpjegon teogoninë tek "Gilgameshi". Jo më kot romani modern ngjante kaq i ri për lexuesit në shekujt 18-të dhe 19-të. Tek përmendja delikate që bën Floberi për dhimbjen vaginale që e gjora dhe e marra Ema Bovari ndjen pas takimeve të shpeshta me të dashurin e saj Rudolfin, ne nuk vërejmë thjesht përshkrim të ri të detajuar seksual (sado i tërthortë) dhe vëzhgim të imët të realitetit i cili do të përbënte thujasë përkufizimin e rrëfimit realist. Vërejmë gjithashtu se romanet

moderne depërtojnë në botën vetiake dhe të fshehtë në mënyra të papërfytyruara nga ndonjë art i mëparshëm. Kjo rëndësi moderne e vetes mund të gjurmohet tek filozofët e shquar duke nisur nga Dekarti, Rusoi dhe deri tek Kanti. Ose tek ekonomia e kapitalizmit, analizuar nga Marksi dhe Ruskini. Mund të kërkohej edhe tek teologjia themelore protestante, nga Martin Luteri tek Jonathan Edvard, ku gjemë rrënjët e unit modern tek përqendrimi i vëmendjes fetare të lëvizjes së Reformaonit tek shpirti individual. Romanet luajtën rol themelor për kulturën pjesërisht sepse ishin e vetmja formë e arritshme arti me gjerësinë e mjaftueshme për të përfshirë të gjitha detajet që ju duheshin autorëve në vizatimet e

portreteve gjithnjë e më realiste të personazheve të tyre. Por, para së gjithash, romanet përshkruan atë që dukej se ishte krizë e unit modern. Dhe në nivelin më të lartë dhe më serioz artistik, ato ofruan zgjidhje. E vërteta e trishtueshme është se romani tani nuk ka të njëjtin terren të gjerë kulturor, dhe lexuesit nuk para kanë përshtypjen se romani është mënyrë praktike e shtjellimit të problemeve. Rënia e autoritetit të tij pasqyron një krizë të re e cila ka lindur si pasojë e mossuksesit në rritje të guximit intelektual të kulturës sonë dhe dyshimit për zhvillimin e mëtejshëm të vetë romanit. Rrallë ndjehet mungesa e prozës në këtë epokë të internetit. Përveç mundësive zbavitëse digjitale, letërsia masive në gjuhën angleze ka lulëzuar

duke shfaqur pjekuri të befasese. Gjinia e biografisë përcjell mësimet që jepte romani dikur, ashtu si edhe sociologjia e paraqitur në mënyrë masive dhe "Gazetaria e Re", e cila përdor teknikat e shkrimit romanor për reportazhe të gjata. Prapëseprapë, romani është në agoni. Dështimi i tij paralajmëron fundin e besimit tek vlerat e të kaluarës dhe qëllimet e ardhshme të asaj që e konceptoi veten si kultura perëndimore. Shenjat e një kulture të dobësuar, të pasigurt dhe ngurruese shkruhen në pluhurin e librave të palexuar të rafteve të bibliotekave tona. Ndryshimi më i madh sociologjik (ende jo i vlerësuar sa duhet) në Amerikë gjatë 50 viteve të fundit është rënia e jashëzakonshme e përqindjes së anëtarëve të kishave protes-

tante nga afërsisht 50 përqind në vitin 1965 në më pak se 10 përqind sot. Ky kolaps hoqi një kolonë qendrore të identitetit amerikan. Megjithëse të tjerët ishin të mirëpritur, brenda dhe jashtë, ne kuptuam se në thelb jetonim si një komb protestant. Kishat mbizotëruese ishin ato të Misisipit kulturor që përshkonin vatrën e të kuptuarit të vetes nga kombi. Kur ky pus ushqyes shteroi, kultura e vjetër vdiq në plloçat e ngurta të baltës. Themelet teologjike u rrënuan, dhe kështu ndodhi edhe me institucionet kulturore të ndërtuara mbi ato themele, duke përfshirë edhe romanin.

Me zhdukjen e një horizonti kohor, historia duket se nuk ka qëllim të dallueshëm, dhe kultura nuk ka qëllim të dukshëm. Pa qëllimet dhe arsyet e dikurshme, gjithçka mbetet janë krimet e së kaluarës që kultura ka bërë për të arritur atje ku është tani. Të pa dëmshpërblyera nga arritjet, të pashpëjguara nga qëllimi, këto mëkate të pazhbëra ka gjasë të ngjajnë tronditëse: ta përkufizojnë kulturën. Dhe pa një kuptim për qëllimet dhe arsyet e dikurshme, pse duhet të përpiqemi për të ardhmen? Pse duhet të shkruajmë, apo edhe të lexojmë, krijime letrare sa një libër për të kuptuar veten?

Pra, sot nuk shqetësohemi shumë më për këto libra. Nuk i japim mësim rregullisht në kolegje. Nuk presim që madje as të arsimuarit të kenë njohuri për këtë formë arti. Bibliotekat e lagjeve kanë hequr dorë nga të qenët depo të historisë letrare, duke zhvendosur disa kopje të romaneve të Dikensit dhe Heminguejt në sektorin e librave për të rinjtë dhe duke shpërndarë botimet e dobëta. Pavarësisht nga pozitat e tyre në universitete të cilat rëndësinë e marrin nga autoriteti që letërsia kishte dikur, studiuesit e letërsisë studiojnë tani pornografinë e kartolinave të turpshme franceze me të njëjtat mjete dhe ngazëllim që kishin dikur për romanin.

Kjo nënkupton një lloj laicizmi pavetor, çrrënjosje të elementëve të fundit të pandërgjegjshëm të një lloj krishtërimi kulturor. Romani më serioz synoi ri-magjepsjen. I kishte dëshirën e zjarrtë për t’u dhënë një lloj shkëlqimi objekteve të botës, duke qëndruar përballë kthesave moderne të shkencës teknologjike, qeverive burokratike dhe ekonomisë tregtare.

Nga shekulli 18 deri në shekullin e 20-të, autorët krijuan letërsi të pangjashme me asgjë që bota kishte lexuar më parë. Ata e bënë këtë sepse ishte e nevojë e civilizimit. Dhe ai i shpërbleu për këtë. Nga autorët që kanë botuar romane që nga fillimi i viteve 1990-të, asnjëri prej tyre nuk është kthy-

er në lexim të detyrueshëm. Kjo mungesë e rëndësisë kulturore nuk është domosdoshmërisht faji i autorëve, thjesht ne s’lexojmë romane siç lexonim më parë. Ambiciet e mëdha janë zvogëluar dhe motori i artit zhumëron duke nxjerrë shtël-lungat e fundit të karburantit të vjetër. Kriza metafizike e modernizmit nuk u zgjidh as nga romani dhe as nga ndonjë gjë tjetër. Si pasojë, po përjetojmë një krizë të dytë, atë të dobësimit të artit, pasi kultura po humbet horizontet dhe domethënien e qëllimit.

Kjo s’do të thotë se nuk është krijuar letërsi e rëndësishme gjatë gjysmës së shekullit të kaluar. Kjo ka ndodhur duke nisur nga V.S. Naipaul, Mario Vargas Llosa, Thomas Pynchon, Philip Roth and Don DeLillo (të pestë të lindur në vitin 1930) tek J.M. Coetzee dhe John Irving (të dy të lindur në fillim të viteve 1940-të), ashtu si dhe autorë më të hershëm, të gjithë kanë jetësuar ambiciet e romanit. Për dekada me radhë, lexuesit serioz kanë rrëmbyer për lexim çdo botim të ri nga Martin Amis, Salman Rushdie dhe Cormac McCarthy. Nuk jam ndonjë admirues i madh i veprës së Ian McEwan-it dhe Jonathan Franzen-it siç jam për çdo krijim letrar të Marilynne Robinson-it, A.S. Byatt-it dhe Michael Chabon-it, por të gjithë është e nevojshme të lexohen nëse ndjekim zhvillimin e letërsisë bashkëkohore. Zadie Smith, Haruki Murakami, Orhan Pamuk, Arundhati Roy, Jeffrey Eugenides dhe shumë të tjerë përbëjnë listën e e shkëlqyer të shkrimtarëve serioz bashkëkohorë.

Pavarësisht sa të talentuar janë, asnjë prej tyre s’na bën ta përjetojmë romanin ashtu siç na bëjnë autorët themelorë anglezë, nga Daniel Defoe e deri tek Jane Austen. Ose siç na bëjnë ta përjetojmë autorët e shquar të periudhës Viktoriane, nga Dickens-i dhe Thackeray tek Henry James. Ose siç na bëjnë modernistët, nga Proust-i dhe Joyce tek Thomas Mann-i dhe Ralph Ellison-i. Apo edhe siç bëjnë romancierët e mesit të shekullit të 20-të, nga Fitzgerald, Faulkner dhe Hemingway tek Sinclair Lewis dhe John Steinbeck.

Mund të parashatrojmë të njëjtin argument po të përsiasim për epokën në të cilën po jetojmë e cila është e artë për romancat, letërsinë fantastiko-shkencore, romanet detektiv, të krimeve, misterit dhe tmerrit. Neil Gaiman është një gjeni i llojit të tij, i cili po hulumton letërsinë për fëmijë, fantazitë urbane dhe romanet me vizatime. Dean Koontz përdor tmerrin në mënyrë të maskuar për të bërë pyetje metafizike në lidhje me zhgën-

jimin e botës. “Game of Thrones” (Froni i shpatave) e George R. R. Martin-it është një model i krijimeve me imagjinatë të fuqishme i botëve në epokën e pas-Tolkien-it, ndërsa Gene Wolfe përdori letërsinë fantastiko-shkencore për të një projekt letrar me ngjyime katolike për më shumë se 30 vjet.

Kini parasysh dy autorët më të shitur që nga Agatha Christie janë Stephen King dhe J.K. Rowling. Pas tyre vijnë të gjithë autorët dhe artistët e përfshirë në zhvillimin e plotë të librave komik në romane me vizatime: heroi botëndryshues i Alan Moore-it dhe Frank Miller-it “Jimmy Corrigan” i Chris Ware, Maus i Art Spiegelman-it, “Persepolis” e Marjane Satrapi-t. Talenti i tyre shtrën pyetjen se pse i lëvrojnë këto gjini. Kur sheh dikë të ngrejë një libër të përsosur në aspektin teknik apo një libër komik në nivelin më të lartë të artit, kjo të bën të pyesësh veten se pse këta autorë nuk shkruajnë romane


ambicioze, pse nuk punojnë me formën artistike të romanit që kultura jonë ka punuar për ta zhvilluar në një mjet me finesë, hapësirë dhe fuqi të jashtëzakonshme për gati tre shekuj. Në druajtjen tonë për arrogancën e pyetjes, pyetja gjen përgjigjen e saj.

Robert Heinlein me letërsinë fatanstiko-shkencore, P.G. Wodehouse me komeditë romantike dhe Rex Stout me romanet e misterit, asnjëri nga këta mjeshtër s’do ta kishte problem po t’i thuhej se s’bënte letërsi që ishte në nivelin e një Nobelisi bashkëkohor si Mann-i. Kur kemi përshtypjen e diçkaje elitare e cila shpërfill dallimin midis “letërsisë serioze” dhe “letërsisë masive”, jemi ne që zbulojmë se nuk besojmë më në fuqinë e formave të vjetra të letërsisë serioze, mosbesim që nuk do të ishte pranuar nga shkrimtarët më të mirë të lloji të dytë të letërsisë në brezat e mëparshëm, nga Arthur Conan Doyle deri tek Dr Seuss.

Ideja e rënies së romanit nuk është pohim se ka pasur më shumë gjeni krijuese në shekujt e mëparshëm ose se kjo gjeni krijuese po e harxhon vetveten duke lëvruar artin masiv. Përkundrazi, është pohim se qëllimi i madh i romanit modern ishte të ri-magjepste kuptimin tonë për botën me rrëfime të trilluara që vendosin në mënyrë paralele udhëtimin shenjtërues të shpirtit me udhëtimin fizik dhe shoqëror të trupit. Qëllimi ishte që të ndërthurte sërish së bashku realitetet e brendshme dhe të jashtme të cilat epoka moderne i kishte ndarë. Dhe ndërsa kultura perëndimore has në pengesa, pa qenë më e sigurt se problemet e modernizimit mund të zgjidhen, projekti i vjetër duket pak joreal.

Nuk është romani shkaku pse ne dështuam. Ne jemi shkaku pse dështoi romani./exlibris.al/

The Spectator, shkurt 2020.
Përktheu: Granit Zela
Photo by Fabiola Peñalba on Unsplash



The Decline of the Novel

Joseph Bottum

E rrallë

Vodhi 5 800 ulëse biçikletash për ta lehtësuar stresin në punë

Policia e Osakës në Japoni ka sekuestruar rreth 5 800 ulëse biçikletash, ndërsa në pranga është vënë një shofer kamioni i cili akuzohet për vjedhje. Hiroaki Suda, 57 vjeç, u arrestua më 13 shkurt pasi një kamerë sigurie e kapi duke vjedhur dy



ulëse biçikletash. Suda ka pranuar akuzat. "Unë fillova të vidhja ulëset e biçikletave rreth 25 vjet më parë në Tokio dhe Osaka për ta lehtësuar stresin në punë dhe gradualisht, mbledhja e tyre doli të ishte argëtuese".

FOTO E DITES



Një bari shihet me disa dele duke kaluar portën kufitare Cilvegozu me Sirinë. /AP/

E jashtëzakonshme

Çifti norvegjez bëhen të parët në 1 000 vjet që martohen në një ceremoni tradicionale vikingësh

Të gjithë i kanë ëndrrat e tyre kur martohen dhe duan ta përjetojnë dasmën e tyre të ëndrrave, ku do të jenë princesha apo princër. Por, një çift norvegjez ka dashur të bëjë diçka tjetër krejt të pazakontë, duke u bërë të sapomartuar në stil vikingësh. Në këtë formë ata realizuan ceremoninë e parë



në stilin e vikingëve, që realizohet në më se 1 ,000 vjet. Rune dhe Elizabeth Dalseth nuk deshën një ceremoni të zakonshme, por shkuan afër një liqeni dhe gjithçka e realizuan sikur vikingët e vjetër, si para dhjetë shekujsh.

BARSOLETA E DITËS



Femra: Zemër, blima një picë!
Djali: Me çka?
Femra: Me përshutë.
Djali: Po pyes me çka ta blej, se centin s'e kam.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Atmosfera është plot me mundësi konstruktive, sidomos në punë dhe nga ana financiare. Jeta sociale do t'ju ofrojë shumë ide.

**DEMI**

Edhe pse Afërdita kontribuon për ta ruajtur optimizmin tuaj, Urani dhe Neptuni ju krijojnë tensione në punë dhe në jetën private.

**BINJAKËT**

Mërkuri bëhet më harmonik duke jua bërë mjaft pozitive ditën tuaj. Në punë mund të keni promovime dhe shpërblime për shkak të ideve dhe krijimtarisë tuaj.

**GAFORRJA**

Duke gjykuar pozicionin e yjeve, periudha që po kaloni nuk është e lehtë, por pikërisht disa pakënaqësi në punë dhe në jetën private do t'ju bëjnë pak nervoz dhe jo tolerant.

**LUANI**

Me Diellin dhe Mërkurin në shenjë energjite fizike dhe përqendrimi do të jenë në maksimumin tuaj duke jua dhënë mundësinë të përparoni nga ana profesionale, duke sugjeruar ide dhe projekte.

**VIRGJËRËSHA**

Afërdita është pikërisht pranë jush dhe do të jetë një ditë shumë e ngarkuar me punë, gjithash-tu do të jetë edhe dita ku ju do të merrni vendime shumë të rëndësishme.

**PESHORJA**

Pozicioni aktual i Mërkurit në shenjë duket se do të jetë mjaft i përshtatshëm për të gjithë ju që i përkisni kësaj shenje. Mbarëvajtja në punë ju vlen jo vetëm ekonomikisht.

**AKREPI**

Situata yjore për ju nuk është nga më të mirat, prandaj ju kërkohet përqendrimi maksimal në punë dhe në fushat e tjera të jetës. Afërdita pozitive është një garanci më shumë për sektorin e erotit.

**SHIGJETARI**


Do të keni një mori problemesh përpara, por për fatin tuaj të mirë është Marsi në një pozicion të përshtatshëm që ju sjell energjitë e nevojshme për të përballuar situata të vështira.

**BRICJAPI**

Mjafton që Afërdita të "nxjerrë pak kokën" për të bërë që të paktën në fushën sentimentale të mos keni asnjë problem. Një lajm i papritur që ju vjen mund të bëjë ta ndryshoni taktikën.

**UJORI**

Në përgjithësi shenja juaj dominohet nga yje që stimulojnë së tepërmi anën sentimentale, prandaj ka shumë të ngjarë që sot të jeni shumë të impenjuar në raportet ndërpersonale.

**PESHQIT**

Sot ju këshillohet të tregoheni të vëmendshëm, e çka është më e rëndësishmja për ju, të mos jeni edhe aq konfidenciale me të parin që takoni në rrugë.

Lady Gaga e la duhanin brenda një sekonde



Lady Gaga ka publikuar një këngë të re dhe ka hequr dorë nga një ves i vjetër. Në një intervistë për “New Music Daily with Zane Love” këngëtarja tha: “S’pi më cigare, por më parë

pija 40 copë në ditë. Hoqa dorë menjëherë, jo gradualisht. Ishte shumë e vështirë. Nëse nuk pini duhan, mos e nisni. Ta lësh është më e vështirë se ta nisësh”, ka thënë Gaga.

Maroon 5 kritikohet për performancën në Kili



Maroon 5 thotë se vështirësitë teknike janë për t’u fajësuar për shfaqjen e tyre të çuditshme në festivalin Vina del Mar në Kili javën e kaluar. Këngëtari Adam Levine u shfaq i hutuar dhe i parehatshëm gjatë gjithë performancës së grupit të tij që po transmetohej drejtpërdrejt në TV. Ylli ishte “i ftohtë, i shpërqëndruar dhe i preokupuar”, ka shkruar gazeta “La Tercera” e Santiagos. 40-vjeçari më vonë u shpjegua. “Problemet me zërim ndikuan në mënyrën se si kam vepruar në skenë, e cila ishte joprofesionale dhe kërkoj falje për këtë”, ka thënë ia.

drejt në TV. Ylli ishte “i ftohtë, i shpërqëndruar dhe i preokupuar”, ka shkruar gazeta “La Tercera” e Santiagos. 40-vjeçari më vonë u shpjegua. “Problemet me zërim ndikuan në mënyrën se si kam vepruar në skenë, e cila ishte joprofesionale dhe kërkoj falje për këtë”, ka thënë ia.



Kendall Jenneri dëshiron të jetë asistentja personale e Beyonces

Modeluesja e njohur Kendall Jenner ka treguar se është një adhuruese e madhe e këngëtares së njohur Beyonce. Ajo në një intervistë gjatë kampanjës së pranverës së Calvin Klein ka deklaruar se do të pëlqente të punonte me Beyoncen.

“Nëse do të kisha mundësinë të isha asistentja personale e ndokujt për një vit do të isha asistentja e Beyonces, pasi do të dëshiroja të di se çfarë konsumon ajo në mëngjes”, ka thënë Jenneri. Ajo më tej ka shtuar se do të mund ishin mike të ngushta, shkruan “People”.

Julia Roberts blen shtëpi 8.3 milionë dollarëshe



Aktorja Julia Roberts ka blerë një shtëpi 8.3 milionë dollarë në San Francisco. Shtëpia mahnitëse është në lagjen ekskluzive të Presidio Heights. Roberts e bleu shtëpinë më 12 dhjetor të 2019-s. Shtëpia e re e fitueses së Oscarit ka

një dhomë me më shumë se 1 000 shishe të verës. Njëra nga dhomat e gjumit ka një pamje spektakolare të urës Golden Gate. Shtëpia u projektua nga arkitekti Sylvain Schnaittacher dhe është ndërtuar afërsisht rreth viteve 1907-1908.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Vizer: Populli i Kosovës ka shpirt luftarak, krenohuni me Majlindën

PRISHTINË, 1 MARS - Presidenti i Federatës Botërore të Xhudos, Marius Vizer, gjatë javës së kaluar qëndroi në Kosovë. Ai ishte i pranishëm në ceremoninë për përzgjedhjen e më të mirëve nga Komiteti Olimpik i Kosovës "Laureatët 2019" si dhe në përfundimin e shtatorës së sportistes më të suksesshme kosovare, Majlinda Kelmendit, shtatore kjo që pikërisht ishte dhuratë nga organizata që Vizer udhëheq. I pari i xhudos në botë në një intervistë për "KosovaPress" shprehur kënaqësinë e të qenit sërish në Kosovë, derisa vlerësoi lart të arriturat e xhudistëve të Kosovës dhe Federatës së Xhudos në arenën ndërkombëtare. "Është një nder i madh për mua që të jem i ftuar dhe të marrë pjesë në Galën e Komitetit Olimpik. Isha plot emocione sepse i mbaj mend të gjithë hapat e procesit të pranimit, kur forcave të ndryshme u bënë së

bashku me kryetarin e Komitetit Olimpik, ish-ministrin e Sportit dhe shumë njerëz të sportit nga Kosova, por më në fund ishte shpërguar. Tani Kosova mund të jetë krenare që e kanë pranuar plotësisht në Komitetin Olimpik, një komitet i respektuar dhe me medalje të artë të arritur në lojërat Olimpikë në Rio", ka thënë Vizer. Sa i përket sportistes më të suksesshme nga Kosova, Majlinda Kelmendi, i pari i xhudos botërore u shpreh se ai e njeh që një kohë të gjatë xhudisten nga Peja dhe shpreson që ajo ta përsërisë suksesin e arritur në lojërat Olimpikë "Rio 2016". "Unë e njoh Majlindën që prej kohësh pas pranimit në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos. Më vonë ishte Kampionati Botëror për Junior në Paris dhe për herë të parë ishte duke u intonuar himni i Kosovës dhe flamuri i Kosovës ishte aty. Singërisht unë isha duke



qarë nga emocionet dhe respekti për përpjekjet e saj dhe përpjekjet e Federatës së Xhudos. Me këtë rast unë dua ta përgëzoj kryetarin Agron Kuka, trajnerin Dritonin dhe të gjithë anëtarët e federatës për rezultatet më të mira të arritura nga ta dhe më shumë se kaq është një rast i vetëm që

rezulton nga Majlinda që vërtetohet se Kosova ka një sistem të fortë metodik në xhudo dhe shpresoj që në lojërat e radhës Olimpikë në Tokio ata do ta kenë mundësinë të marrin edhe më shumë medalje", ka deklaruar ai. Për fund, Vizer u shpreh se është i impresionuar me punën që është

bërë nga organizatat sportive pas pranimit të Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe, sipas tij, shpirti luftarak i një shteti siç është Kosova bën gjithçka të mundur. "Unë jam i impresionuar me të vërtetë për të gjitha përpjekjet për pranim pasi Kosova u pranua. Unë mendoj se shpirti i kombit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm sepse edhe në fillim ishte shumë i vështirë pranimi dhe pothuajse nuk kishte shanse, mirëpo shpirti luftarak dhe shpirti i fortë si dhe profili i një kombi krenar më në fund bëri gjithçka të mundur", ka përfunduar Vizer. Kujtojmë se kjo nuk ishte vizita e parë e Vizerit në Kosovë, pasi që ai ka qenë edhe më herët në shtetin tonë dhe njihet si një ndër personat që e ka ndihmuar Kosovën më së shumti në procesin e pranimit në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar.

Ballkani e Prishtina ndajnë pikët, përfiton Drita

PRISHTINË, 1 MARS - Janë zhvilluar katër ndeshje në kuadër të javës së 20-të në Ipko Superligë. Interesimin më të madh në këtë javë e ka zgjuar ndeshja ndërmjet Prishtinës dhe Ballkanit që është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në praninë e rreth 8 000 tifozëve. Përballja e këtyre dy skuadrave që luftojnë për titullin e kampionit u mbyll pa fitues dhe pa gola. Kësajsoj, skuadra nga Theranda e ruajti epërsinë prej tri pikësh ndaj Prishtinës, por tashmë ka vetëm një pikë më shumë se Drita, e cila dje realizoi fitore kundër Drenicës.

Fitore që e mban në hap me skuadrat e kreut ka shënuar kampioni në fuqi, Feronikeli,



duke e mposhtur Trepçën '89 me shifrat 3-0. Golat e këtij takimi në "Rexhep Rexhepi" i shënuan Mendurim Hoti, Mevlan Zeka dhe Albert Dabiqaj. Mysafirët që nga minuta e 26-të luajtën me një lojtar më pak pas përjashtimit të Lassine Traore. Fitore me rezultat bindës ka realizuar edhe Gjilani, por si mysafir i Dukagjinit në Klinë, me shifrat 4-0. Tomislav Busiq (2'), Sabino Plaku (25'),

Franc Velu (79') dhe Gerhard Progni (89') shënuan në fitoren e rëndësishme të gjilanasve. Ndërkohë, Ferizaj ka shënuar fitore në duel me Llapi, me rezultat 2-0, triumf ky i cili i jep shpresa në garën për mbetje në elitë. Të dy golat për ferizajasit i shënoi Dren Gashi.

Klubet, garë të 'nxehtë' në Ligën e Parë

Ka përfunduar java e tetëmbëdhjetë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Në këtë xhiro ka dështuar skuadra e Besës së Pejës, e cila ka pësuar humbje nga Dardana (1-0), kurse këtë humbje të skuadrës pejane e

IPKO SUPERLIGA			LIGA E PARË		
Prishtina - Ballkani	0-0		Vllaznia e Pozheranit - KEK-u	1-0	
Ferizaj - Llapi	2-0		Trepça - Onix Banja	1-0	
Feronikeli - Trepça '89	3-0		Arbëria - 2 Korriku	3-2	
Dukagjini - Gjilani	0-4		Liria - Ulpiana	1-1	
Drita - Drenica	4-1		Vëllaznimi - Ramiz Sadiku	0-1	
			Dardana - Besa	1-0	
			Istogu - Drenasi	1-0	
			Vitia - Malisheva	0-0	
Të hënën takohen: 13:00 Flamurtari - Vushtrria					
TABELA			TABELA		
1. Ballkani	20	Pikë 41	1. Besa	18	Pikë 34
2. Drita	20	40	2. Arbëria	18	33
3. Gjilani	20	38	3. Malisheva	18	30
4. Prishtina	20	38	4. Istogu	18	29
5. Feronikeli	20	31	5. Liria	18	27
6. Llapi	20	28	6. Onix	18	26
7. Trepça '89	20	26	7. 2 Korriku	18	26
8. Drenica	20	24	8. Dardana	18	26
9. Flamurtari	19	22	9. Drenasi	18	24
10. Ferizaj	20	22	10. KEK-u	18	24
11. Vushtrria	19	15	11. Ulpiana	18	22
12. Dukagjini	20	9	12. Trepça	18	22
			13. Vllaznia (P)	18	19
			14. Ramiz Sadiku	18	18
			15. Vëllaznimi	18	17
			16. Vitia	18	16

shfrytëzoi për mrekulli Arbëria që doli fituese ndaj 2 Korrikut (3-2) dhe në këtë mënyrë është vetëm një pikë pas Besës. Një tjetër dështim e ka regjistruar skuadra e Lirisë në përballje me Ulpianën (1-1) dhe tash prizrenasit renditen në pozitën e

katërt në Ligën e Parë. Edhe Vëllaznimi pësoi humbje në Gjakovë nga Ramiz Sadiku (0-1) dhe rrezikon seriozisht të bjerë edhe nga Liga e Parë.

Prishtina mbetet pa trajner, Hojc jep dorëheqje

PRISHTINË, 1 MARS - Slloveni Teo Hojc ka dhënë dorëheqje nga posti i trajnerit të KB Sigal Prishtinës pas rezultateve të dobëta në ndeshjet e fundit.

Lajmin e ka konfirmuar klubi kampion i Kosovës në basketboll të dielën nëpërmjet rrjeteve sociale. "Është fakt që skuadra jonë në kohët e fundit

nuk po paraqitet në nivelin e pritur, për këtë arsye ndiej obligim të marr përgjegjësi. Unë dua t'ju informoj se po jap dorëheqje nga posti i

kryetrajnerit", është thënë në letërën e trajnerit Hojc drejtuar klubit. Prishtina të shtunën u mposht 89:82 në Prizren nga Bashkimi.



Bashkimi e fiton derbin ndaj Prishtinës, Trepça mposhti Feronikelin

PRIZREN, 1 MARS - Bashkimi ka fituar derbin e vjetër ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 89:82 (28:13, 10:36, 25:23, 26:10) në kuadër të javës së 26 në Superligën e Kosovës në basketboll. Takimi ishte shumë interesant dhe me shumë kthesa gjatë

ndeshjes. Prizrenasit e nisën më mirë takimin, duke e fituar çerekun e parë 28:13. Por, në periudhën e dytë u kundërpërgjigjën prishtinasit 10:36, për të shkuar në pushim me rezultat 38:49. Perioda e tretë ishte e barabartë në parket (25:23),

derisa në 10 minutat e fundit vendasit u treguan më të mirë, duke e fituar këtë pjesë 26:10 dhe për të triumfuar në fund me rezultat 89:82. Te Bashkimi u dalluan Stevie Clark me 17 pikë, 12 kërcime e nëntë asistime dhe Terik Bridgeman me 22 pikë,

kurse te Sigal Prishtina më i miri në parket ishte Anthony Goods me 22 pikë. Bashkimi tani ka 14 fitore dhe nëntë humbje, kurse Sigal Prishtina 17 fitore dhe gjashtë humbje. Ndërsa Trepça ka shënuar fitore të rëndësishme në luftën për



mbijetesë, duke e mundur Feronikelin me rezultat 71:62.

Muriqi për ushtarët turq: Heronjtë tanë po bien martirë në Siri

STAMBOLL, 1 MARS - Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, i ka lartësuar ushtarët turq të vrarë së fundmi në një konflikt në Siri, duke i quajtur heronj dhe martirë, pas barazimit të skuadrës së tij, Fenerbahçe, kundër Antalyasporit të shtunën në Superligën e Turqisë. Ylli nga Prizreni ka thënë se ishte e vështirë të luhej në rrethana të tilla, duke nënvizuar se në jetë ka gjëra më të rëndësishme se futbolli. Muriqi po i referohej vrasjes së 33 ushtarëve turq në një sulm të qeverisë siriane në zonën veriperëndimore të Sirisë, Idlib, e cila kontrollohet nga opozita. Kosovari shënoi në barazimin e Fenerbahces 2-2 me Antalyaspor, duke e gjetur rrjetën e portës pas një mungese goli në disa ndeshjet e fundit dhe festoi duke e bërë përshëndetjen ushtarake, e cila u mirëprit në Turqi. Kjo nuk



është hera e parë që Muriqi bën veprim të tillë në fushë, pavarësisht se UEFA e kishte paralajmëruar Turqinë kundër një përshëndetjeje të tillë ushtarake verën e vitit 2019. Por, pas ndeshjes ai tha: “Ushtarët tanë heronj ranë martirë. Është e vështirë të luash në këtë mjedis, sepse ka gjëra më të rëndësishme sesa futbolli. Shpresoj se nuk do të

humbim më shumë (ushtarë)”, ka thënë Muriqi. Skuadra e Muriqit ngel në pozitën e shtatë me nëntë pikë më pak se lideri Trabzonspor, i cili e ka një ndeshje më shumë në dispozicion për ta zhvilluar. “Sot shënova, por ne nuk fituam. Shpresoj se fati do të na buzëqesh dhe shpresojmë të fitojmë javën e ardhshme”, ka shtuar Muriqi.

Lakersat ‘bien’ në Memphis, Westbrook u ‘nderon’ Rocketsat

MEMPHIS, 1 MARS - Memphis Grizzlies i ka dhënë fund serisë prej pesë humbesh radhazi pasi ia doli të triumfojë me shifrat 105-88 përballë kryesuesve të Konferencës së Perëndimit, Los Angeles Lakers, që regjistruan kështu humbjen e 13 sezonale. Në “FedEx Forum” të Memphisit vendësit patën kontrollin e lojës në tre fraksionet e para të lojës, të udhëhequr edhe nga një ndeshje mjaft e mirë e basketbollistit amerikan Morant, që shënoi 27 pikë, rikuperoi gjashtë topa dhe dha 14 asistime. Lakersat u zgjuan vetëm në fraksionin e fundit, por fitorja me 3 pikë diferencë nuk ndikoi aspak në rezultatin final, ndërsa në këtë takim mbetën në hije yjet e skuadrës kaliforniane si LeBron James dhe Anthony Davies. Houston Rockets vijon ngritjen në renditje, pasi në transfertën ndaj Boston Celticsit mori fitoren e gjashtë radhazi, ndonëse vuajti jo pak dhe për të dalë triumfues iu desh të luante edhe kohën shtesë, duke qenë se koha e rregullt u mbyll në barazim. Vendasit e udhëhequr nga Tatum dhe Smart patën kon-



trollin e lojës në gjysmën e parë të saj dhe krijuan një epërsi të konsiderueshme, por pësuan një “black out” total në fraksionin e tretë, ku edhe humbën avantazhin, ndërsa zgjimi në fund nuk i çoi më shumë se barazimi. Nga ana tjetër, Rockets, i udhëhequr nga Westbrook, që shënoi 41 pikë, dha pesë asistime dhe rikuperoi 8 topa, arriti të fitojë me vetëm një pikë diferencë në kohën shtesë dhe gjithë takimin me rezultatin 110-111. Rikthehet te fitorja edhe Golden

State Warriors, që triumfoi në transfertën ndaj Phoenix Sunsit me shifrat 99-115, megjithatë ky rezultat nuk mjafton aspak për t’iu larguar fundit të renditjes në Konferencën e Perëndimit, aty ku kanë mbetur që prej fillimit të sezonit. Në sfidat e tjera, San Antonio Spurs fitoi me vetëm një pikë diferencë përballë Orlando Magicut, Atlanta Hawks triumfoi 129-117 ndaj Portland Trail Blazersit dhe Indiana Pacersi mposhti 103-111 Cleveland Cavaliersin në transfertë.

SHKURT

Tre sulmues pëlqehen nga Reali, Liverpooli dhe Barça

Real Madridi po vuan shumë në sulm, pasi Karim Benzema nuk është në formën e tij më të mirë. Sprinti final i sezonit nuk e ka gjetur ekipin spanjoll aty ku duhet. Rezultatet e dobëta në kampionat dhe humbja ndaj Manchester Cityt janë tregues të qartë. Numri një i stolit, Zinedine Zidane, po mendon për sezonin e ardhshëm dhe ka tre emra në listën e tij. Timo Werner, Erling Haaland dhe Lautaro Martinez janë sulmuesit që pëlqehen në Madrid. Reali për këta lojtarë do t’i ketë konkurrentë Liverpoolin dhe Barcelonën.

Juve, gati të ofrojë 70 milionë euro për Jesusin

Dënimi i Manchester Cityt me dy vjet përjashtim nga Liga e Kampionëve mund të bëjë që shumë yje të largohen nga kjo skuadër. Një nga lojtarët që pritet të largohet është edhe sulmuesi brazilian Gabriel Jesus. Reprezentuesi brazilian është objektiv kryesor i kampionit të Italisë, Juventusit, për repartin ofensivë. Mediat italiane kanë raportuar se tanimë drejtori sportiv i Joves, Fabio Paratici, ka qenë në Angli dhe ka pasur një takim me brazilianin dhe agjentin e tij. 22-vjeçarit i pëlqen ideja të luajë për Juventusin dhe nuk e ka mohuar transferimin te kampioni italian. Juventus tani duhet ta bindë Cityn që të heqë dorë nga ylli i tyre, por për të arritur deri te Jesus, “Zonja e Vjetër” duhet të shpenzojë së paku 70 milionë euro. Jesus këtë edicion është paraqitur në 36 ndeshje në të gjitha garat ku ka shënuar 18 gola dhe ka bërë nëntë asistime.

Bayerni: S’ka justifikim, do të marrim masa ndaj tifozëve

Bayern Muncheni kundër Hoffenheimit fitoi me rezultatin 6-0, por sfida e tyre u prish nga parullat e turpshme të tifozëve ultras të bavarezëve, të cilat ofendonin personalisht pronarin e Hoffenheim Dietmar Hopp. Presidenti i Bayernit, Karl-Heinz Rummenige, paralajmëron se do të ketë pasoja pas asaj që e quajti një ditë të errët për futbollin. “Nuk ka asnjë justifikim për atë që ndodhi në seksionin e tifozëve tanë. Ishte një anë shumë e shëmtuar e Bayernit, në një ndeshje ku skuadra po luante mrekullisht. Kemi pamje filmike të incidenteve dhe do të marrim masa strikte ndaj personave përgjegjës për diskreditimin e klubit. Kemi mbyllur për shumë gjatë njërin sy për atë që po ndodhte me tifozët tanë”. Gjyqtari ndërpreu ndeshjen për disa minuta, lojtarët u rikthyen në fushë dhe nisën t’i pasonin topin njëri-tjetrit deri në vërshëllimën përfundimtare.

Klopp: Pas humbjes së parë mund të luajmë futboll të lirshëm

Jurgen Klopp e ka shikuar anën e ndritshme të disfatës së parë të Liverpoolit në 44 ndeshje në Premierligë dhe shpreson se tani kur skuadra e tij nuk është më nën presion për ta mbyllur sezonin si e pamposhtur, ajo do të mund të luajë futboll lirshëm. Liverpooli e vizitoi stadiumin Vicarage Road të shtunën pasi i kishte fituar 18 ndeshje radhazi në ligë, vetëm një fitore larg rekordit të ri, ndërsa ishte pa humbje në 44 ndeshje radhazi. Por Watfordi bëri një paraqitje të mrekullueshme për t’i tronditur të kuqtë, me Ismaila Sarr që i shënoi dy gola dhe një asistimi për Troy Deeney. Kjo humbje nuk ka gjasa të ketë ndikim në përpjekjet e Liverpoolit për ta fituar titullin në ligë këtë sezon, pasi skuadra e Kloppit vazhdon të prijë me 22 pikë, por nënkupton se ajo nuk do të jetë në gjendje të bëhet skuadra e dytë që e mbyll sezonin në Premierligë pa asnjë humbje. “Ne do ta humbim një ndeshje dokurdo. Ne nuk e prisnim, por ka qenë e qartë se do të ndodhte. Ndodhi dhe unë e shoh si pozitiv faktin që iu kemi afruar këtyre rekordeve. Tani ne mund të luajmë futboll lirshëm përsëri dhe nuk kemi pse të përpiqemi për të arritur rekord. Tani vetëm do të përpiqemi t’i fitojmë ndeshjet dhe këtë do ta bëjmë”, ka thënë Klopp.

	Autor: GAZMEND MORINA		PËRMASË	SHËNIME QË MBAHEN NË NJË FLETË LETRE A NË NJË REGJI- STËR (shq.)	VARRI I NJË SHENJTORI MYSLIMAN	INDIUM, ELEKTRON	POLITIKANI YNË PASKAL	UGANDA, TANZANIA	SHTET NË EVROPË (pashq.)	EPOKA ERE	BASHKËT.	NJË PLANET	KOLOS	
	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)									NJË LLOJ BUFI QË KA TË BËJË ME FSHATIN, FSHATARESKE				
	QË KA HUM- BUR NJOMË- SINË, I FISHKUR										“RIZONI” KALORËS MESJETAR (shq.)			
	SHKRIMTARI YNË GOJANI							EMËR YNI MASHKULLI POLITIKANI SUEDEZ BILDT						
	KËNGËTARJA ... ZARI					VEGËL MUZI- KORE ZANORE								
	➡						RROGË VJET- ORE E PAPËS BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE					NAPOLI ALEANCË		
	PAGJAKËSI SULFUR, NIKEL					QYTET NË MAQEDONI SHTAGA								LETRA
IMER CANA					PYLL PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT				ZOG I EGËR GRABITQAR ISH FUTBOLLI- STI HOLANDEZ KLAIVERT					
EPOKA ERE	LËNG I TRAS- HË QË NXIR- RET NGA KUL- LIMI I NAFTËS	GAZ QË PËR- DORET PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT (shq.)	ELEMENT KIMIK (NT)	OLIVER (shk.)	GAZETË QË BOTOHET NË SHQIPËRI	GJELBËRIM NË SHKRETË- TIRË (sh.shq.) ONTARIO, TENESI			BASHKËT. FIJE E HOLLË PAMBUKU	SHKOVA, ECA QË LIDHET ME TEORINË				
QË S'KA LARMË; I MËRZITSHËM							FAZAT AKTORJA ME FAMË BOTËRORE THURMAN					DY BASHKË- TINGËLLORE TOTENHAM		
SHTËPI PLE- QSH (sh.shq.)						BASHKIM I FORTË (sh.shq.) EMËR I VJET- ËR PËR LUB- JANËN							TREVISO TEKSTI QË SHËRBEN SI BAZË PËR NJË FILM	
PREMTIM QË JEPET PËR TË BËRË DIÇKA NË NJË KOHË TË CAKTUAR					AKTORJA DHE KËNGËTARJA TOSKA AKTORJA AMERIKANE RODRIGUEZ				“RODA” QYTET I MADH NË SHBA		“SAN ANTO- NIO” SMALT			
NJË (IT.)				USHTRIA AKTORI I FAMSHËM ANGLEZ BLOOM					TRA I ÇATISË ZËRI I FORTË QË NXJERR NJERIU KUR BËRTET				LLOJ KOSI ME HUDHRA	
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS COSTA					AMERICA ONLINE DY ZANORE		IPSVICH PËRPJEKJA PËR TA VRARË NJË POLITIKAN	URATAT AUCKLAND HOME EDUCATORS						
EPOKA ERE	ZEJTAR (shq.)	DEPARTMENT OF REVENUE	PORTIERI SPANJOLL PEPE REGJISORI HALILI				TË BUKURIT MA JEP			QYTETI FRANCEZ I FILMIT ILLINOIS VIRTUAL SCHOOL				
KËNGËTARE E JONA E NJOHUR											DAFINË SHTET NË AZI			
KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN					ZANORE ANTALYA		E TRAN-SME- TOVA, E MJET LUFTË					RAMADAN AVDIU DY ZANORE		
DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA						KËNGËTARJA ... OKSA AKTOR KOMEDISH			BIMË NJËV- JEÇARE ME KËRCËLL TË FORTË (shq.) ZILIA, INATI				TROYES DAULLE	
INTER			NAMIK DOKLE MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT		KENNEDY ROAD TABERNACLE METALI I HOLLUAR			KRAHINË NË SHQIPËRI KUMBARA			SLOGAN BASHKËT.			
DY BASHKË- TINGËLLORE				OSMANËT AUDIO VIDEO INTERLEAVE						BETIM (bised.) DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EDIE		“URUGUAI” KATËR (romak)		
FILM I YNI “... ISHIN KATËR”					QË I ËSHTË PËRCAKTUAR MADHËSIA (F.) EMMY ROSSUM				BASHKËT. DY BASHKË- TINGËLLORE		DJALË I VËL- LAIT A I MOTRËS LLOJ REVO- LEJE		TEFTA TASHKO	
LARTËSIA QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË							NISMAT ZANORE							
QË KA TË BËJË ME PARAARDH- ËSET TONA							I AFROVA (bised.)					NITON		



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

Bordi i Drejtorëve i KRM "Çabrati" Sh.A., në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2020, bën këtë:

NJOFTIM

1. Anulohet konkursi i datës 24.01.2020 për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Çabrati" Sh.A. me arsyetimin se konkursi ka defekte teknike dhe procedurale;
2. Bordi i Drejtorëve i KRM "Çabrati" Sh.A. ka vendosur që të bëjë rishpallje të konkursit publikë për këtë pozitë me datë 04.03.2020;
3. Ky njoftim do të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e KRM "Çabrati" Sh.A.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Basholli Compani", SH.P.K. me pronar Safet Basholli, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 811388637 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Basholli Compani" D.O.O. sa vlasnik Safet Basholli, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NRB: 811388637 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Basholli Compani", L.L.C, Safet Basholli, has come to the decision to quit its business NRB: 811388637 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

C.nr.919/2019

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Kryetari i kolegjit, Gjyqtari Skender Shala, në çështjen juridike të paditësit Agim Jashari nga Fsh. Vinarc i Poshtem, Komuna e Mitrovices, të cilën sipas autorizimit me shkrim e perfaqson av. Fitim Vokshi nga Mitrovica, kundër të paditueses Dijana Cedomirovic - Jashari nga Kroacia, tani me adrese të panjohur, për zgjidhje të martesës, në bazë të nenit 79 pika 2, të LPK, me datën 11.02.2020, bie:

AKTVENDIM

Të paditueses Dijana Cedomirovic - Jashari nga Kroacia, tani me adrese të panjohur, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm avokat Jetullah Berisha nga Mitrovica, i cili do të kryej të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor dhe do ta përfaqësojë të paditurën në këtë çështje juridike, gjersa e paditura ose i/e autorizuari i saj të paraqiten në këtë gjykatë.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.919/2019, dt. 11.02.2020.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë.
Për informata në tel: 044-444-009

► N.P. "Graniti" shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër: 601035068.

► Kreshnik Krasniqi shpall të pavlefshme katër dëftesat e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

**Blerim Geci
shpall të
pavlefshme
certifikatën e
biznesit me nr:
811338715, All
Productions
SH.P.K me seli
në Skenderaj**

AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173
045 626 123
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020

